

**TIRANË 2023**



**FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE  
DEPARTAMENTI I LËNDËVE PARAKLINIKE**

**SUKSESI I NËNAVE AUTORITARE TEK  
FËMIJËT ME ÇRREGULLIME TË AUTIZMIT**

**Disertacion**

**Për marrjen e Gradës Shkencore**

**DOKTOR**

**Disertanti: Eliona Sula**

**Udhëheqës Shkencor: Prof. Asoc. Dr. Floreta Kurti**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE**

**DISERTACION**

*I PARAQITUR NGA*

**Znj. Eliona SULA**

**PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE**

**DOKTOR**

**TEMA: “SUKSESI I NËNAVE AUTORITARE TEK FËMIJËT  
ME ÇRREGULLIME TË AUTIZMIT”**

**MBROHET NË DATË: ...../..... PARA JURISË:**

1. ....KRYETAR
2. ....ANËTAR (OPONENT)
3. ....ANËTAR (OPONENT)
4. ....ANËTAR
5. ....ANËTAR

## **Parathënie**

*Fëmijët autikë manifestojnë “kushte të shumëllojshme që ndërhyjnë në proceset komunikuese-relative, duke krijuar forma të ndryshme komunikimi dhe përpunimi të informacionit”, gjë që i vendos ata në një disavantazh të dukshëm social. Kuptimi gjithëpërfshirës i kësaj gjendje, nënkupton të kuptuarit e kontekstit në të cilin ata ndërveprojnë, “përvojat që kanë në jetën e tyre dhe kryesisht, mbështetjen që ata kanë për të kapërcyer, vështirësitë e këtyre përvojave dhe modelet edukative, të cilave u nënshtrohen”. Kjo mbështetje dhe qëndrim i afërt ndaj personave autik, ka një vlerë të madhe, jo vetëm për ta, por për të gjithë mjedisin e tyre familjar.*

*Në mjedisin e personave autikë zhvillohen dhe janë shumë të rëndësishme proceset e afrimit dhe të shoqërimit familjar, sepse personat autikë shfaqin kushte të shumëllojshme, për të cilat afrimi dhe shoqërimi i familjes është transhendent. Megjithatë, afrimiteti me familjen dhe stili i prindërimit adekuat është tejmase i nevojshëm për individët me autizëm. Autoriteti, përgjegjësia, dashuria, respekti, vlerësimi i shprehur ndaj fëmijës, janë shumë të rëndësishme në zhvillimin e mëtejshëm të tij/saj. Kjo për arsye se nëpërmjet stilit të prindërimit, prindi i mëson fëmijës rregullat, strukturën, limitet, e ndihmon të zhvillojë aftësitë gjuhësore, komunikimin, përdorimin e një game të gjerë fjalësh, komunikimin joverbal, e ndihmon të zhvillojë aftësitë sociale dhe emocionale.*

*Shpresojmë që ky studim të japë ndihmesën e tij në vlerësimin dhe përmirësimin e stilit të prindërimit për fëmijët autike në vendin tonë, duke ndikuar kështu në zhvillimin dhe përmirësimin e komunikimit, aftësive socio-emocionale tek këta fëmijë.*

## ***Falënderim***

*Falënderoj udhëheqësin shkencor*

*Prof. Asoc. Dr. Floreta Kurti për ndihmën*

*në të gjitha etapat e studimit.*

*Falënderoj familjen time,*

*për mbështetjen dhe kurajon,*

*për të përfunduar me sukses këtë projekt shkencor.*

## **Shkurtesa**

ASD	Autism Spectrum Disorede
AS	Asperger's Syndrome
DSM	Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders
PSDQ	The Parenting Style and Dimension Questionnaire
OBSH	Organizata Botërore e Shendetësisë
CDC	Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve
PCA	Analiza e komponentit kryesor
SES	Socio-economic status
HVA	Acidit Homovalinik
KMO	Kaiser-Meier-Olkin
M	Mesatare
SD	Standard Deviation

## Përmbajtja

KAPITULLI 1 .....	13
HYRJA .....	13
1.1 Sfondi i problemit .....	13
1.2 Rëndësia e studimit .....	14
1.3 Qëllimi dhe objektivat e studimit.....	14
Objektivat e studimit.....	14
1.4 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat .....	14
KAPITULLI 2.....	15
RISHIKIMI I LITERATURËS .....	15
2.1 Përkufizimi i stileve të prindërimit .....	15
2.1.1 Stili autoritar.....	16
2.1.2 Stili lejues.....	16
2.1.3 Stili autoritativ .....	16
2.2 Teoria e Eleanor Maccoby .....	16
2.2.1 Stili i prindërimit lejues ose tolerant.....	17
2.2.2 Stili i prindërimit asertiv ose demokratik .....	17
2.3 Modeli dydimensional i stileve të prindërimit sipas Martin dhe Maccoby.....	17
2.3.1 Stili autoritativ-reciprok.....	17
2.3.2 Stili autoritar-totalitar .....	18
2.3.3 Lejues-tolerant.....	18
2.3.4 Lejues-neglizhues .....	18
2.4 Perceptimi i stileve të prindërimit.....	18
2.4.1 Refuzimi dhe kontrolli .....	19
2.4.2 Ngrohtësia emocionale .....	19
2.4.3 Mbimbrotjtja.....	19
2.4.4 Favoritizmi .....	19
2.5 Teoria e Steinberg mbi stilet e prindërimit.....	20
2.6 Karakteristikat e fëmijëve .....	21
2.6.1 Stili autoritar.....	21
2.6.2 Stili lejues.....	21
2.6.3 Stili autoritativ .....	21
2.6.4 Stili neglizhues .....	21
2.7 Aftësitë sociale.....	21
2.8 Autizmi.....	24
2.8.1 Përkufizimi.....	25
2.8.2 Etiologjia dhe prevalenca.....	26
2.8.3 Diagnostikimi .....	29
2.8.3.1 DIMENSIONI SHOQËROR .....	30
2.8.3.2 DIMENSIONI I KOMUNIKIMIT DHE GJUHËS .....	31
2.8.3.3 DIMENSIONI I PARASHIKIMIT /FLEKSIBILITETIT .....	31

2.8.3.4 DIMENSIONI I SIMBOLIKËS .....	32
2.8.4 Autizëm me mungesë komunikimi .....	33
2.8.5 Komunikimi dhe gjuha tek fëmijët autikë me mungesë komunikimi .....	34
2.8.5.1 Komunikimi paralinguistik .....	34
2.8.5.2 Komunikimi kinezik .....	35
2.8.5.3 Komunikimi proksimik .....	36
2.8.5.4 Komunikimi kronik .....	36
2.8.5.5 Komunikimi diakritik .....	37
2.8.6 Komunikimi joverbal i shprehjes së emocioneve.....	38
2.9 Teoria e Winnicott dhe autizmi .....	39
2.9.1 Rritja dhe zhvillimi .....	39
2.9.2 Roli i nënës në zhvillimin e psikikës së fëmijës .....	41
2.9.3 Mungesa e nënës në zhvillimin psikik të fëmijës .....	42
2.9.4 Shqetësimi dhe mbështetja e ofruar prej nënës.....	43
2.10 Teoria e mendjes dhe autizmi .....	45
2.11 Teoria e koherencës qendrore .....	45
2.12 Teoria e “trurit jashtëzakonisht mashkullor” .....	46
2.13 Teoria e funksioneve ekzekutive .....	46
2.14 Teoria e ndërsjektivitetit .....	47
KAPITULLI 3.....	48
METODOLOGJIA .....	48
3.1 Qëllimi i studimit .....	48
3.2 Objektivat e studimit .....	48
3.3 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat .....	48
3.4 Dizajni i studimit .....	49
3.5 Kampioni .....	50
3.6 Instrumentat .....	50
3.7 Vlefshmëria .....	52
3.8 Besueshmëria .....	55
3.9 Metoda e mbledhjes së të dhënave.....	59
4.0 PROCEDURA .....	67
4.1 Metodologjia e analizës statistikore.....	68
KAPITULLI 4.....	69
REZULTATET .....	69
KAPITULLI 5.....	108
DISKUTIM.....	108
KAPITULLI 6.....	112
PËRFUNDIME .....	112
SHTOJCA.....	114
BIBLIOGRAFIA.....	120





## Lista e tabelave

Tabela 4. 1 Karakteristikat socio-demografike nënave të fëmijëve autike.....	69
Tabela 4. 2 Stilet e prindërimit .....	72
Tabela 4. 3 Pikëzimi sipas nënshkallëve të stileve të prindërimit .....	73
Tabela 4. 4 Korrelacioni i moshës së nënës me nënshkallët e stilit të prindërimit .....	77
Tabela 4. 5 Korrelacioni i moshës së fëmijëve me nënshkallët e stilit të prindërimit .....	78
Tabela 4. 6 Nivelet e aftësive sociale të fëmijët me autizëm për shkallën totale .....	79
Tabela 4. 7 Nivelet e aftësive të para bazë .....	79
Tabela 4. 8. Nivelet e aftësive të avancuara .....	79
Tabela 4. 9 Nivelet e aftësive që lidhen me ndjenjat .....	80
Tabela 4. 10 Nivelet e aftësive alternative ndaj agresionit .....	80
Tabela 4. 11 Nivelet e aftësive për të përballuar stresin.....	80
Tabela 4. 12 Nivelet e aftësive të planifikimit .....	81
Tabela 4. 13Krahasimi i stilit të prindërimit dhe nivelet e aftësive sociale tek fëmijët me autizëm.....	83
Tabela 4. 14Testi i normalitetit Kolmogorov-Smirnov .....	84
Tabela 4. 15 Pikezimi i nënshkallëve të aftësive sociale për totalin e fëmijëve .....	84
Tabela 4. 16 Pikezimi i nënshkallëve të aftësive sociale të fëmijëve sipas grupmoshës ..	85
Tabela 4. 17 Korrelacioni ndërmjet stileve të prindërimit dhe aftësive sociale të fëmijët me autizëm për shkallën totale.....	91
Tabela 4. 18 Korrelacioni i stileve të prindërimit me shkallën e aftësive sociale.....	92
Tabela 4. 19 Korrelacioni i stilit autoritativ të prindërimit dhe niveleve aftësive sociale.	93
Tabela 4. 20 Korrelacioni i stilit të prindërimit autoritar dhe niveleve të aftësive sociale	93
Tabela 4. 21Korrelacioni i stilit lejues të prindërimit dhe niveleve të aftësive sociale.....	94
Tabela 4. 22Korrelacioni i stilit të prindërimit neglizhues dhe niveleve të aftësive sociale .....	94
Tabela 4. 23 Korrelacioni i stilit të përzier prindëror dhe niveleve të aftësive sociale .....	95

## Lista e figurave

Figura 4. 1 Karakteristikat sociodemorafike të nënave .....	70
Figura 4. 2 Shpërndarja e fëmijëve sipas grupmoshës .....	71
Figura 4. 3 Frekuenca e stileve të prindërimit .....	72
Figura 4. 4 Krahasimi i pikëzimit sipas nënshkallëve të stileve të prindërimit .....	73
Figura 4. 5 Krahasimi i pikëzimit të nënshkallëve të stileve të prindërimit sipas vendbanimit .....	74
Figura 4. 6 Krahasimi i pikëzimit të nënshkallëve të stileve të prindërimit sipas nivelit arsimor .....	75
Figura 4. 7 Krahasimi i pikezimit të nënshkallëve sipas nivelit ekonomik .....	76
Figura 4. 8 Korrelacioni i moshës së nënës me nënshkallët e stilit të prindërimit .....	77
Figura 4. 9 Korrelacioni i moshës së fëmijëve me nënshkallët e stilit të prindërimit .....	78
Figura 4. 10 Frekuenca e defiçitit dhe arritjes sipas nënshkallëve dhe shkallës totale të aftësive sociale .....	82
Figura 4. 11 Krahasimi i stilit të prindërimit dhe nivelet e aftësive sociale tek fëmijët me autizëm.....	83
Figura 4. 12 Pikëzimi i nënshkallëve të aftësive sociale për totalin e fëmijëve .....	85
Figura 4. 13 Pikëzimi i nënshkallëve të aftësive sociale të fëmijëve sipas grupmoshës...86	
Figura 4. 14 Niveli i shkallës totale të aftësive sociale sipas stilit autoritar dhe autoritativ dhe grupmoshës.....	87
Figura 4. 15 Pikëzimi i nënshkallëve të aftësive sociale të fëmijëve sipas grupmoshës dhe sipas stilit autoritar .....	88
Figura 4. 16 Pikëzimi i nënshkallëve të aftësive sociale të fëmijëve sipas grupmoshës sipas stilit autoritativ .....	88
Figura 4. 17 Niveli i stresit tek prindërit .....	89
Figura 4. 18 Niveli i stresit sipas ashpërsisë së ASD .....	89
Figura 4. 19 Niveli i stresit sipas stilit të prindërimit .....	90
Figura 4. 20 Korrelacioni ndërmjet stileve të prindërimit dhe aftësive sociale te fëmijët me autizëm. Shkalla totale. ....	91
Figura 4. 21 Korrelacioni i llojeve të stileve të prindërimit dhe nivelit të aftësive sociale të fëmijëve.....	92
Figura 4. 22 A keni rregulla që fëmija juaj duhet të ndjekë gjatë ditës?.....	96
Figura 4. 23 Nese Po, ku janë të shfaqura?.....	96
Figura 4. 24 Çfarë rregullash shtëpiake prisni që ai/ajo të ndjekë? .....	97
Figura 4. 25 Sa mirë funksionon kjo sjellje me fëmijën tuaj? .....	98
Figura 4. 26 A ka fëmija juaj punë ose përgjegjësi të rregullta që ai ose ajo pritet të bëjë çdo ditë ose çdo javë?.....	98
Figura 4. 27 Shpërblimi nëse i bën?.....	99
Figura 4. 28 Pasojat nëse nuk i bën? .....	99

Figura 4. 29 Sa mirë funksionon kjo sjellje me fëmijën tuaj? .....	100
Figura 4. 30 Cilat sjellje rezultojnë në dhënien e reagimeve korigjuese, qortimit ose bërthitjes ndaj fëmijës tuaj? .....	101
Figura 4. 31 Sa shpesh e korigjoni, bërtisni apo qëlloni fëmijën?.....	101
Figura 4. 32 Sa mirë funksionon kjo sjellje me fëmijën tuaj? .....	102
Figura 4. 33 Cilat sjellje çojnë në heqje të privilegjit nëse fëmija sillet keq? .....	102
Figura 4. 34 Sa shpesh ja hiqni privilegjet?.....	103
Figura 4. 35 Sa mirë funksionon kjo sjellje me fëmijën tuaj? .....	103
Figura 4. 36 Çfarë merr ai/ajo si shpërblim, dhe/ose privilegj?.....	104
Figura 4. 37 E fiton shpërblimin shpesh fëmija juaj? .....	104
Figura 4. 38 A humbet fëmija juaj një shpërblim për sjellje te keqe?.....	105
Figura 4. 39 Sa mirë funksionon kjo qasje me fëmijën tuaj? .....	105
Figura 4. 40 Brenda një dite, sa kohë ka kaluar fëmija juaj me prindin në shtëpi? .....	106
Figura 4. 41 Sa përqind të kohës e dini se ku ndodhet fëmija juaj kur ai/ajo është larg mbikëqyrjes suaj të drejtpërdrejtë? .....	106
Figura 4. 42 Sa përqind të miqve të fëmijës suaj i njihni mirë? .....	107

## Abstrakt

**Hyrje:** Autizmi është një çrregullim, i cili prek aftësitë njohëse dhe sociale, që ka implikime të rënda në aftësinë e individit të prekur, për të bërë një jetë produktive dhe të pavarur. Rritja alarmante e incidencës së ASD në dekadën e fundit, sugjeron ndërkohë; që faktorët gjenetikë janë kontribues; shkaktarët mjedisorë gjithashtu duhet të luajnë një rol vendimtar.

**Qëllimi:** Të nxjerrë në pah ndikimin dhe impaktin që ka stili i prindërimit tek fëmijët me autizëm, duke ndikuar kështu në zhvillimin dhe përmirësimin e komunikimit, aftësive socio-emocionale dhe arritjeve akademike.

**Materiali dhe metoda:** Studimi u krye gjatë periudhës 2013 - 2017. Në studim u përfshinë 168 fëmijë me spektrin e autizmit, nga Qendra për mbështetje dhe integrimin e fëmijëve me çrregullime të zhvillimit “Ecim Së Bashku”, në Tiranë dhe në Durrës. Fëmijët janë të moshës nga 3 vjeç deri 10 vjeç. Fëmijët janë si nga zona urbane ashtu edhe nga zona rurale. Në studim janë përfshirë gjithashtu edhe nënat e fëmijëve.

**Rezultate:** Në studim mbizotëron stili autoritativ i prindërimit 55.4%, ndjekur nga 26.2% një stil autoritar (26.2), i përzier (9.5%), një stil lejues (5.4%) dhe një stil prindërimi neglizhues (3.6%). Në total në stilet e prindërimit paraqesin një nivel të deficiteve të aftësive sociale prej 78%, ndërsa 22% kanë përvetësuar aftësitë sociale. Me rritjen e moshës së fëmijës dhe zhvillimin e aftësive bazë dominon stilit autoritativ sepse me rritjen e moshës edhe fëmijët kuptojnë më tepër dhe prindërit frenohen më tepër për ti qortuar ashpër apo mbajtur me forcë.

Stili autoritar i prindërimit u përdor nga nënat me fëmijë me çrregullime të spektrit të autizmit në formë të rëndë. Nënat raportuan nivel të lartë të stresi kur përballëshin me kontrollimin e sjelljeve vetë dëmtuese të fëmijëve të tyre duke përdorur stil prindërimi autoritar.

Arritjet më të mëdha janë për nënshkallën autoritative me 30.1% ( $p=0.05$ ). U gjet korrelacion sinjifikant pozitiv i shkallës së aftësive të fëmijëve me stilin autoritativ dhe korrelacion negative me stilin autoritar.

**Përfundime:** Stili autoritativ i prindërimit, përmirëson komunikimin dhe rrit aftësitë socio-emocionale dhe arritjeve akademike të fëmijëve me autizëm.

**Fjalë kyç:** Stili i prindërimit, stres, aftësi sociale, fëmijë, autizëm

# KAPITULLI 1

## HYRJA

### 1.1 Sfondi i problemit

Autizmi ka krijuar polemika dhe kontradikta në mjedisin shkencor që nga mesi i shekullit të kaluar (Sulo, 2022). Deri në fund të shekullit të 20-të, ai quhej autizëm infantil i parakohshëm (Kanner 1943). Aktualisht, DSM-5 (American Psychiatric Association 2013) e konsideron autizmin si një nga çrregullimet e zhvillimit neurologjik të pranishëm në subjekte me manifestime të sjelljes dhe njohëse në shkallë të ndryshme, ndërsa Klasifikimi Statistikor Ndërkombëtar i Sëmundjeve dhe Problemeve Shëndetësore të Lidhura e konsideron atë si një nga çrregullimet e përhapura të zhvillimit (Nano, 2017).

Fëmijët autikë manifestojnë “kushte të shumëllojshme që ndërhyjnë në proceset komunikuese-relative, duke krijuar forma të ndryshme komunikimi dhe përpunimi të informacionit”, gjë që i vendos ata në një disavantazh të dukshëm social. Kuptimi gjithëpërfshirës i kësaj gjendje nënkupton të kuptuarit e kontekstit në të cilin ata ndërveprojnë, “përvojat që kanë në jetën e tyre dhe, kryesisht, mbështetjen që ata kanë për të kapërcyer vështirësitë e këtyre përvojave dhe modelet edukative të cilave u nënshtohen”. Kjo mbështetje dhe qëndrim i afërt ndaj personave autik ka një vlerë të madhe, jo vetëm për ta, por për të gjithë mjedisin e tyre familjar.

Në mjedisin e personave autikë zhvillohen dhe janë shumë të rëndësishme proceset e afrimit dhe të shoqërimit familjar, sepse personat autikë shfaqin kushte të shumëllojshme, për të cilat afrimi dhe shoqërimi i familjes është transhendental. Megjithatë, është afrimiteti me familjen dhe stili i prindërimit adekuat është tejmase i nevojshëm për individët me autizëm. Autoriteti, përgjegjësia, dashuria, respekti, vlerësimi i shprehur ndaj fëmijës janë shumë të rëndësishme në zhvillimin e mëtejshëm të tij/saj. Kjo për arsye se nëpërmjet stilit të prindërimit, prindi i mëson fëmijës rregullat, strukturën, limitet, e ndihmon të zhvillojë aftësitë gjuhësore, komunikimin, përdorimin e një game të gjerë fjalësh, komunikimin joverbal, e ndihmon të zhvillojë aftësitë sociale dhe emocionale.

Por kjo është një marrëdhënie didaktike, fëmija ndikon prindin dhe prindi ndikon tek fëmija. Në këtë kontekst stili i prindërimit modelon sjelljen e fëmijës, duke i treguar pritshmëritë që ka prej tij, por nga ana tjetër prindërit mund të dekurajohen në varësi të llojit dhe tipareve të autizmit që ka fëmija. Prindi përpiket vazhdimisht në të gjitha mënyrat dhe pret që fëmija të reagojë, por nuk reagon dhe kjo gjendje e lodh duke hequr dorë nga ndërveprimi me fëmijën. Herë-herë mund të shikojmë prindër të tjerë me fëmijët e tyre dhe mund të mendojë “Çfarë problemi ka fëmija im?”. Kjo sepse prindi nuk e ka informacionin e nevojshëm, ndoshta e di me anë të atij instiktit prindëror që fëmija ka

diçka (një problematikë të caktuar), ndoshta aludon, kërkon informacion për ta kuptuar fëmijën dhe mund ta mohojë realitetin duke thënë që kjo është vecse një fazë.

## **1.2 Rëndësia e studimit**

Rëndësia e këtij studimi konsiston në të kuptuarin e stileve të prindërimit, thelbit dhe ndikimit që ato kanë mbi fëmijën, duke formësuar dhe brumosur sjelljen e tij. Nga ana tjetër, është e rëndësishme të kuptohet se cili prej stileve të prindërimit është më i suksesshmi me fëmijët me autizëm. Duke njohur karakteristikat, simptomat dhe tiparet e fëmijëve me autizëm, këta fëmijë kanë nevojë për njëfarë strukture, rregulli, rutine; për të mësuar dhe zhvilluar aftësi të caktuara.

## **1.3 Qëllimi dhe objektivat e studimit**

Qëllimi i këtij studimi është të nxjerrë në pah ndikimin dhe impaktin që ka stili i prindërimit tek fëmijët me autizëm, duke ndikuar kështu në zhvillimin dhe përmirësimin e komunikimit, aftësive socio-emocionale dhe arritjeve akademike.

## **Objektivat e studimit**

1. Të paraqesë teori të ndryshme përsa i përket stileve të prindërimit
2. Të paraqesë etiologjinë, prevalencën, diagnostikimin, simptomat dhe teori të ndryshme në lidhje me autizmin.
3. Të klasifikojë dhe përshkruajë deficitet sipas fushave të caktuara të fëmijëve me autizëm.
4. Të kuptojë e stileve të prindërimit dhe ndikimin që ato kanë mbi fëmijën me autizëm
5. Të masë nivelin e stresit te nënat e fëmijëve me autizëm.

## **1.4 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat**

1. Cili prej stileve të prindërimit është më i suksesshëm në lidhje me fëmijët autik?

## KAPITULLI 2

### RISHIKIMI I LITERATURËS

---

#### 2.1 Përkufizimi i stileve të prindërimit

Me kalimin e kohës, stileve të prindërimit i është kushtuar më shumë rëndësi, derisa tashmë është bërë një fjalë e përdorur në specializime të ndryshme si: Sociologji, Psikologji dhe Pedagogji. Pavarësisht kësaj, studimet e stileve të prindërimit të prindërve përfaqësohen nga ndryshimet terminologjike që ndodhin si rezultat i modifikimeve kulturore dhe sociale gjatë viteve (Morales, 2014). Morales (2014) argumenton se është procesi me të cilin, gjatë viteve të para të jetës, prindërit kontribuojnë në formimin fizik dhe spiritual të foshnjave, ku faza e parë është thelbësore për konfigurimin e emocioneve dhe personalitetit të tyre. Sipas Capano et al (2010), është një term që përdoret gjerësisht në kërkimet mbi efektet e socializimit të familjes në kompetencën e fëmijëve dhe adoleshentëve. Sipas Huta (2012), e para që e përdori këtë koncept ishte Diana Baumrind në 1968 i njëjti që u riformulua më vonë nga disa autorë. Timpano et al (2010) thekson se ato janë sjellje të kryera nga prindërit ndaj fëmijëve të tyre. Aktualisht, kur sjelljet kanë stabilitet dhe qëndrueshmëri, i referohet me termin “stili”, pavarësisht kohës, mund të ketë modifikime për shkak të zhvillimit evolutiv të fëmijëve dhe/ose moshës (Climent, 2009).

Salirrosas dhe Saavedra (2014) pohojnë se stilet e prindërimit janë thelbësore për rritjen ose kufizojnë mjetet dhe burimet psikologjike për t'u përballur me rrethana të ndryshme transhendentale që lindin më vonë. Ai i referohet stileve të prindërimit për një grup sjelljesh të ekzekutuara nga prindërit që janë relevante sepse ata janë të përkushtuar të mbrojnë fëmijët e tyre dhe të kujdesen për ta gjatë fazës së fëmijërisë deri në adoleshencë. (Salirrosas dhe Saavedra, 2014) Rrjedhimisht, prindërit transmetojnë bindje, mençuri, vlera, role, qëndrime dhe zakone, të cilat kalojnë nga një brez në tjetrin. Dashuria, dialogu dhe komunikimi është niveli i mbështetjes dhe vlerësimit të dukshëm për fëmijët, niveli i lartë ose i ulët i komunikimit midis fëmijëve dhe prindërve (Vega, 2006).

Po kështu, Darling dhe Steinberg (1993) theksojnë se është e mundur që në stilin e edukimit prindëror të ekzistojnë mënyra të ndryshme të karakteristikave të fëmijëve, të cilat transmetojnë dhe prodhojnë një gjendje emocionale të shëndetshme ose të dëmshme në varësi të mënyrës se si prindi kryen, ekzekuton sjelljen e tij. Po kështu, ata e kuptojnë sjelljen me të cilën prindërit kërkojnë përmbushjen e disa detyrimeve, si një model tjetër sjelljeje, qofshin këto modifikime në zë, gjeste dhe emocione.

Diana Baumrind (1966) vlerëson se ekzistojnë tri stile të socializimit, të cilat janë stili autoritar, lejues dhe autoritativ, këto janë përshkruar më poshtë.

### **2.1.1 Stili autoritar**

Është kur prindërit nuk marrin parasysh dëshirat, kërkesat dhe nevojat e fëmijëve të tyre. Ndaj kryejnë një monitorim të ashpër dhe kufizues, me detyrim normal. Po kështu, përdoret frikësimi, privimi i vazhdueshëm dhe korigjimet e përsëritura fizike. Komunikimi është vertikal pasi prindërit janë ata që duhet të informojnë për dispozitat e tyre pa marrë parasysh mendimin e fëmijëve, duke shprehur mosinteresim për arritjet dhe iniciativat e fëmijëve (Henao, Ramírez, Ramírez, 2007). Prindërit me këtë stil bëjnë përpjekje të mëdha për të ndërhyrë në sjelljen dhe mënyrat e të qenurit të pasardhësve të tyre sipas mënyrave të paravendosura tashmë. Ata kufizojnë autonominë e fëmijëve të tyre, vlerësojnë shumë që janë të bindur, por përdorin refuzimin si ndëshkim, si dhe rendin e ruajtjes dhe traditës (Torío, Peña dhe Rodríguez, 2008).

### **2.1.2 Stili lejues**

Nuk kërkon respektim të rregullave, zbaton pak dënime, duke shmangur kështu kontrollin. Prindërit janë shumë mospërfillës dhe priren të pranojnë që fëmija i tyre është impulsiv. Komunikimi karakterizohet nga pak efektivitet, kjo për faktin se arsyetimi dhe synimet e fëmijëve nuk realizohen. Prindërit me këtë stil lejojnë shumë liri përse kohë që fëmija i tyre nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut. Duhet theksuar se përballë sjelljeve dhe impulseve të fëmijës, prindërit pranojnë dhe janë përbutës. Kjo i bën ata të mos kenë autoritet apo kontroll. Ata nuk janë fleksibël përse i përket përgjegjësisë dhe pjekurisë gjatë ekzekutimit të detyrimeve të tyre. (Baumrind, 1966)

### **2.1.3 Stili autoritativ**

## **2.2 Teoria e Eleanor Maccoby**

Nga tipologjia e stileve të prindërimit të Baumrind-it, Maccoby ripërcakton stilet e prindërimit dhe shton një tjetër stil, neglizhues. Këta prindër tregojnë pak afeksion ndaj pasardhësve të tyre dhe përcaktojnë pak kufizime, pasi u japin fëmijëve të gjithë përgjegjësinë për të dhënë dashuri dhe gjëra materiale. Gjithashtu, ata fokusohen në nevojat e tyre, por pa marrë në konsideratë nevojat e fëmijës së tyre. Duhet theksuar se ky stil ka qenë i asociuar në çrregullimet e ndryshme të sjelljes në fëmijëri dhe adoleshencë.





### 2.2.1 Stili i prindërimit lejues ose tolerant

Peña (2011) pohon se prindërit lejues janë ata që japin dashuri të pakushtëzuar, ku fëmijët nuk kanë kufizime, u jepet shumë liri dhe drejtohen pak, fëmijët nuk kanë kufij, prindërit i pranojnë me dashuri dhe ngrohtësi, pavarësisht nga sjellja e të miturit, edhe nëse nuk është korrekte. Ata nuk pranojnë kritika për punën e tyre. Ky lloj stili “brumos” dhe formëson fëmijë rebelë dhe impulsivë, agresivë, të cilët e kanë të vështirë të përshtaten në shoqëri.

### 2.2.2 Stili i prindërimit asertiv ose demokratik

Peña (2011) thekson se prindërit demokratë janë ata që i mësojnë fëmijët e tyre të kujdesen për veten e tyre, i ndihmojnë, inkurajojnë dhe pranojnë ata, monitorojnë sjelljen e të miturit për të parë nëse rregullat respektohen dhe e përforcojnë atë, mbajnë komunikim të hapur; e gjithë kjo u lejon atyre të jenë prindër më të dashur, duke i udhëhequr me durim dhe pa ndëshkim. Këta prindër, duke pasur këtë stil prindërimi, respektojnë interesat, personalitetin dhe aftësitë e fëmijëve të tyre. Si rezultat, ata kanë fëmijë me vetëbesim të lartë, të cilët janë të aftë në shoqëri, të sigurt, kanë vetëkontroll dhe arrijnë performancë më të mirë në shkollë.

## 2.3 Modeli dydimensional i stileve të prindërimit sipas Martin dhe Maccoby

Garcia dhe de Guzman (2017) përshkruajnë dhe shpjegojnë një model dydimensional dhe shprehen se Maccoby dhe Martin u përpoqën të vlerësojnë stilet e prindërimit si një funksion i dy dimensioneve, të cilat ata i quajtën dashuri/komunikim (përgjegjshmëri) dhe kontroll/kërkesë (kërkues).

### 2.3.1 Stili autoritativ-reciprok

Sipas Garcia dhe de Guzman (2017), fëmijët kanë vetëbesim të lartë, besim, kompetencë sociale dhe vetëkontroll. Po kështu, ata kanë një vetë-koncept realist, koherent dhe

pozitiv dhe i përvetësojnë në mënyrë adekuate vlerat sociale dhe morale. Power (2013) tregojnë se ky lloj prindërisht kryejnë kontroll të arsyetuar dhe të vendosur, zbatojnë parimin e reciprocitetit, por kërkojnë që fëmijët të respektojnë të drejtat dhe detyrat e prindërve; prandaj, prindërit pranojnë përgjegjësinë e tyre dhe praktikojnë sipas rastit. Komunikimi është i hapur, kjo do të thotë se ka më pak intensitet të konflikteve prindër-fëmijë. Po kështu, prindërit ushtrojnë dhe pranojnë përgjegjësinë e tyre ashtu siç u përgjigjet atyre. Ky stil është i përqendruar tek pasardhësit.

### **2.3.2 Stili autoritar-totalitar**

Woolfolk (2011) thekson se ky stil ka më pak efekte pozitive shoqërore se ai i mëparshmi. Kanë pak vetëkontroll, marrëdhënie shoqërore, janë të nënshtuar dhe kanë vetëbesim të ulët dhe ekziston mundësia që të paraqesin sjellje agresive dhe të kenë shumë ankth. Sipas Power (2013), në këtë stil ushtrohet kontroll i fortë prindëror dhe ndryshon për të qenë i rreptë kur mungon reciprociteti dhe komunikimi, duke lënë pak liri. Ekziston rreziku i ulët i devijimeve të sjelljes dhe kohëzgjatja e shkurtër e pasojave pozitive. Ky stil është i përqendruar te prindërit.

### **2.3.3 Lejues-tolerant**

Fëmijët shfaqin gëzim, papjekuri, paaftësi për të kontrolluar impulset dhe nuk janë shumë këmbëngulës. Ata kanë vetëbesim dhe rezultate të larta të vetëbesimit. Power (2013) theksojnë se prindërit nuk ushtrojnë autoritet apo vendosin rregulla apo norma brenda dhe jashtë shtëpisë, dëshirat e fëmijëve pranohen lehtësisht, ata janë tolerantë dhe ndëshkimet janë të pakta. Woolfolk (2011) pohon se ata kanë një nivel të lartë komunikimi, afeksioni dhe dashurie. Karaj (2005) thekson se ekziston rreziku i devijimeve serioze të sjelljes.

### **2.3.4 Lejues-neglizhues**

Ata shfaqin probleme me formimin e identitetit, vetëvlerësim të ulët, kanë një vetë-koncept negativ, nuk respektojnë rregullat, nuk janë shumë të ndjeshëm, janë të pambrojtur, u mungon vetëbesimi dhe përgjegjësia, janë të prirur për të përjetuar përvoja personale dhe konfliktet sociale. Woolfolk (2011) vë në dukje se në këtë rast prindërit tregojnë pak interes për të rritur fëmijët e tyre dhe u japin atyre pak afektivitet, si dhe kërkojnë pak prej tyre. Gjithashtu pohon se është e zakonshme që ata të paraqesin devijime serioze të sjelljes dhe ndryshime psikologjike.

## **2.4 Perceptimi i stileve të prindërimit**

Kiran (2017) flet për një ndryshim rreth konceptit të perceptimit, ku gjejmë dy rryma mendimi: perceptimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Ajo përmend edhe teorinë tjetër të perceptimit, atë indirekte dhe teorinë e përpunimit të informacionit. Contreras (2012) e përkufizon perceptimin si mënyrën në të cilën individit merr informacion nga mjedisi i tij. Po kështu, përmendet edhe përjasja ekologjike e perceptimit të James Gibson, e cila shpjegohet si zbulimi i informacionit që merret drejtpërdrejt nga shqisat dhe që shërben për të drejtuar sjelljen e tyre.

Perris, Jacobsson, Lindström, Von Knorring dhe Perris (1980) përmendin 14 mënyra të perceptimit të stileve të prindërimit. Kiran (2017) përmendin se këto lloje të edukimit

janë pjesë e shkallës EMBU (Egna Minnen Beträffande Uppfostran) që përfshijnë kujtimet e fëmijërisë së dikujt. Aluja et al (2006) tregojnë rreth 14 aspekteve të sjelljes prindërore të formuluar nga Perris et. al., nga kujtesa e sjelljes prindërore. Këto janë: abuzimi, shantazhi emocional, stimulimi, orientimi drejt rezultateve, favorizimi i individit ndaj vëllezërve dhe motrave, toleranca, afeksioni, intruzioni, mbimbrotja/mbiproteksioni, favorizimi i vëllezërve/motrave, refuzimi, ofendime/fyerje verbale, ndëshkimi dhe deprivimi.

Sipas Aluja et al. (2006) në vitet 1980, Arrindell, Emmelkamp, Brilman dhe Monsma vendosën që mënyra e përbashkët e praktikës prindërore e përfshirë në EMBU të përbëhet nga katër elementë të riprodhuar në gjuhë dhe vende të ndryshme si: ngrohtësia, refuzimi, mbimbrotja dhe favorizimi. Në ditët e sotme, këto dimensione të perceptimit të stileve të prindërimit na ndihmojnë të përmirësojmë prindërimin, kështu që marrëdhënia midis prindërimit, psikopatologjisë dhe varësive bëhet e rëndësishme.

#### **2.4.1 Refuzimi dhe kontrolli**

Ai përbëhet nga vrazhdësia e prindërve ndaj fëmijës, ndëshkimi, kritika, armiqësia fizike ose verbale, dimension i refuzimit (Aluja et al., 2006). Po kështu, Salirrosas dhe Saavedra (2014) e përkufizojnë këtë dimension si një dimension që paraqet sjellje ndëshkuese, agresion, përbuzje, shantazh emocional, pritshmëri të ngurta në lidhje me arritjet e fëmijës.

#### **2.4.2 Ngrohtësia emocionale**

Për Kiran (2017), aspektet fizike si përqafimet dhe puthjet përbëhen nga shkalla e ngrohtësisë emocionale ku ka kontakt trupor dhe verbal përmes gjuhës (komplimentet), shprehjeve të mbështetjes, pranimit, respektit, besimit, stimulimit nga prindërit, ngushëllimit përballë fatkeqësive dhe vlerësimit të mendimit të fëmijës. Ndërsa për Villegas et al. (2014) është se fëmijët duhet të ndihen të dashur, të respektuar dhe të mbështetur nga prindërit e tyre.

#### **2.4.3 Mbimbrotja**

Kjo shkallë përshkruan përpjekjen e prindërve për të menaxhuar sjelljen e fëmijës, ata paraqesin shumë shqetësime për atë që bëjnë dhe sigurinë e tyre, kërkesat për arritje në detyrat e kryera nga fëmija dhe shantazhin emocional, ankthin e mbivlerësuar prindëror, imponimin dhe bindjen ndaj rregullave strikte. Nga ana tjetër, përfshin një shkallë të lartë ndërhyrjeje dhe imponimi ndaj fëmijës, ku ka kufij të ngurtë të sjelljes, duke qenë kontroll i tepruar dhe mbrotje ndaj përvojave negative (Villegas et al., 2014).

#### **2.4.4 Favoritizmi**

Shkalla e Favoritizmit vlerëson trajtimin e favorizuar të prindërve ndaj një fëmije në krahasim me vëllezërit e motrat e tjerë. Është e rëndësishme të përmendet se ky dimension konsiston në ekzistencën e fëmijës së preferuar, ky dimension konsiderohet vetëm në disa vende (Villegas et al., 2014).


Rohde et al (2003) përmend rëndësinë që ndiejnë prindërit me fëmijët e tyre për të parë programet dhe filmat që u pëlqejnë, në mënyrë që të ketë komunikim më të rrjedhshëm në familje dhe të shmangët të mësuarit me imitim në aspektin e agresivitetit që më parë,

problemi i fëmijëve agresivë, ka ndodhur vetëm në zonat e marginalizuara, për shkak të familjeve jofunksionale. Megjithatë, sot kjo ndodh edhe tek fëmijët që vijnë nga shkolla të mira dhe familje të krijuara. Është e rëndësishme të përmendet se, aktualisht, çdo fëmijë ka televizorin, kompjuterin dhe lojërat e tij në dhomën e tij, prindërit e favorizojnë atë për të shmangur zënkat mes vëllezërve dhe motrave. Megjithatë, këto mjete shpërqëndruese po shkaktojnë shpërbërjen e familjes. Përveç kësaj, me globalizimin, fëmijët po përdorin në mënyrë të papërshtatshme internetin, i cili u krijua për të pasur më shumë informacion dhe komunikim. Po kështu, që të ketë një bashkim mes njerëzve që nuk janë të afërt.

Nga ana tjetër, Molina (2002) pohon se drejtori i Departamentit të Kërkimit të Sjelljes së Adoleshentëve në Universitetin e Stellenbosch, në Afrikën e Jugut, tregoi se adoleshentët ndjejnë pakënaqësi për të mos pasur marrëdhënie të qëndrueshme dhe pozitive, ndjenjën e përkatësisë, sigurisë, dashurisë, ushqim dhe veshmbathje. Për këtë arsye, prindërit kanë një rol themelor në edukimin dhe kujdesin e fëmijëve të tyre.

## 2.5 Teoria e Steinberg mbi stilet e prindërimit

Steinberg ka arritur të studiojë stilet e prindërimit në lidhje me përshtatjen e sjelljes tek adoleshentët. Për shkak të kësaj, lind shpërndarja që përfshin stilet e prindërimit autoritar, autoritar, lejues, tolerues, neglizhues dhe të përzier, të cilët, mund të gjenden në familjet me fëmijë që janë në fazën e adoleshencës. Kjo u përdor nga Steinberg për krijimin e Shkallës së Stileve të Prindërimit.



Prandaj, Steinberg (Merino dhe Arndt, 2004) ka zbuluar se gjatë fazës së adoleshencës njihen tre dimensione në stilet e prindërimit që mbështeten teorikisht dhe empirikisht:

**Angazhimi:** Njihet si niveli në të cilin adoleshenti intuit sjelljet e qasjes emocionale, afektivitetit dhe prirjes që vijnë nga prindërit e tyre.

**Autonomi psikologjike:** Niveli në të cilin prindërit përdorin taktika demokratike, jokufizuese dhe mbështesin veçantinë dhe autonominë tek fëmijët.

**Monitorimi i sjelljes:** Niveli në të cilin babai kuptohet si kontrollues ose mbikëqyrës i sjelljes së adoleshentëve.

## **2.6 Karakteristikat e fëmijëve**

### **2.6.1 Stili autoritar**

Paraqesin probleme ankthi dhe depresioni, kanë pakënaqësi ndaj prindërve, nuk i përvetësojnë rregullat por i kushtojnë vëmendje, epërsisë së vlerave hedoniste, kjo do të thotë se jetojnë për të shijuar kënaqësitë, duke u përpjekur të shmangin dhimbjen dhe të kenë një vetë-vlerësim më të ulët. Nga frika personi është i nënshtruar, ky stil i bën fëmijët të mos përvetësojnë normat shoqërore, por t'u përmbahen atyre. Duhet theksuar se Talib dhe Mohamad (2015) shpjegon se të rinjtë me këtë stil kanë pasiguri më të madhe, frikë dhe kanë një vetëkoncept të ulët në mjedisin familjar dhe shkollor.

### **2.6.2 Stili lejues**

Fëmijët janë të respektueshëm dhe respektojnë normat shoqërore pasi kanë virtyte të ndryshme. Ata gjithashtu kanë vetëbesim. Ata kanë një vetëkoncept të lartë familjar dhe akademik. Në këtë stil, fëmijët marrin përforcim kur sjelljet e tyre janë të sakta, por kur nuk janë, prindërit i bëjnë ata të reflektojnë për sjelljen e tyre. Kjo mungesë presioni bën që fëmijët e tyre të përvetësojnë normat me kënaqësi më të madhe (Aponte, 2009).

### **2.6.3 Stili autoritativ**

Ajo vendos karakteristika tek fëmijët pasi ata janë të zhvilluar shoqërisht, kanë respekt për vlerat njerëzore, vetëkoncept të lartë familjar, vetëbesim dhe vetëkontroll të lartë dhe performancë optimale akademike. Në këtë stil fëmijët i binden autoritetit; megjithatë, normat janë asimiluar pasi ekziston një komunikim që bazohet në justifikime, shpjegime dhe arsyttime. Sipas Sarwar (2016) fëmijët autoritar priren të shprehin më mirë konceptin e tyre për veten, shëndetin mendor, zhvillimin social dhe kapacitetin social.

### **2.6.4 Stili neglizhues**

Duhet të theksohet se karakteristikat e fëmijëve janë këto: ata gënjejnë më shumë, sjellja e tyre është impulsive, priren të kenë frikë absurde, ankth, aftësi të dobëta sociale, probleme me drogën dhe alkoolin, tendenca për vetëvrasje, vetëbesim të ulët, mosbesim ndaj njerëz dhe arritje të ulëta akademike. Është e rëndësishme të theksohet se ky stil gjeneron rezultate negative tek fëmijët, të cilët mund të paraqesin varësi dhe sjellje agresive pasi prindërit nuk ju vendosin kufij lejueshmërie. Me sa duket, prindërit me këtë stil i udhëzojnë fëmijët të jenë vitalë dhe të gëzuar. Megjithatë, ata kanë nivele të ulëta përkurje, nivele të larta të sjelljes antisociale dhe sukses personal. Këta fëmijë nuk kanë ndjenja turpi para autoriteteve (Torío et al., 2008).

## **2.7 Aftësitë sociale**

Ekzistojnë një sërë termash që lidhen me aftësitë sociale si: marrëdhëniet ndërpersonale, sjellja socio-ndërvepruese, sjellja ndërpersonale, aftësitë e shkëmbimit social, aftësitë e marrëdhënive ndërpersonale, aftësitë ndërpersonale, aftësitë sociale, shkëmbimet sociale, aftësitë e ndërveprimit social, ndër të tjera.

Ka konceptualizime dhe përkufizime të ndryshme rreth aftësive sociale. Ato janë parë si një kapacitet ku kryhet një sjellje shoqërore, duke qenë e favorshme si për të përfshirë,


ashtu edhe për kapacitetet e veprimeve të mësuara, një sjellje shoqërore e aftë. Kështu, Campbell dhe Hansen (2010) thonë se aftësitë sociale janë një grup sjelljesh të emetuara nga njerëzit në një kontekst ndërpersonal, që shpreh mendimet, qëndrimet, ndjenjat ose të drejtat në një mënyrë të përshtatshme për situatën, duke respektuar ato sjellje të njerëzit e tjerë dhe zakonisht zgjidh situatën e afërt, shqetësimet e rrethanave duke reduktuar mundësinë që ato të lindin vështirësitë.

Davies dhe Stone mendojnë se aftësia sociale është një sjellje që favorizon individin sipas interesave të tij më parësore, pa mohuar të drejtat e të tjerëve, por duke ushtruar të drejtat personale, duke shprehur me lehtësi ndjenjat e ndershme ose duke mbrojtur veten pa ankth të papërshtatshëm. Termi kompetencë ose aftësi sociale përdoret për të treguar forma të ndryshme të sjelljeve të mësuara, ku përfshihen sjelljet joverbale dhe verbale, në këtë mënyrë ka rritje sociale.

Nga ana tjetër, Campbell dhe Hansen (2010) shprehet se është një grup sjelljesh që tashmë janë mësuar dhe i lejojnë personit të lidhet me mjedisin rrethues nëpërmjet opinionëve, dëshirave dhe ndjenjave. Është e rëndësishme të theksohet se Davies dhe Stone përcaktuan se aftësia sociale ose sjellja e sigurtë si një aftësi e formuar që personi përdor për të ndërlikur, këto manifestohen nga situatat, mjedisi dhe në varësi të njerëzve, ku ata kanë lloje të ndryshme situatash, rrethanash dhe sjelljesh brenda mjedisit.

Sipas Darling-Churchill et al (2015), treguan se karakteristikat themelore të aftësive sociale janë:

- i.** Është një veçori e individit.
- ii.** Mësohet aftësia e përgjigjes që duhet marrë.
- iii.** Është një cilësi e veçantë e individit dhe e situatës, jo e përgjithshme. Duhet të jetë në mjedisin kulturor të personit.
- iv.** Ai bazohet në cilësinë e një personi që zgjedh lirisht se si të veprojë në një situatë të caktuar.
- v.** Është një veçori e sjelljes efektive shoqërore dhe nuk dëmton.



Sjellja e aftësive sociale është ndarë në pjesën verbale dhe verbale. Pjesa joverbale përfshin: qartësinë, kohën e të folurit, shpejtësinë, tonin dhe përkuljen e të folurit, rrjedhshmërinë, timbrin, lëvizjet e kokës dhe disa komponentë parajohësorë si vonesa, zhurma, shprehja e fytyrës, buzëqeshjet, qëndrimi i trupit, gjestet, distanca, shikimi, zgjerimi i bebëzës së syve dhe pamjen personale. Pjesa verbale i referohet mesazhit tematik të asaj që personi përmend, elemente të komunikimit, brenda këtyre komponentëve përfshihen aspekte të tilla si elemente të caktuara të të folurit (Jurevičienė dhe Kaffemaniene, 2018).

Individi shmang dhe kërkon disa situata. Mënyra sesi ai zgjedh ngjarjet, duke vlerësuar në proceset e tij të dijes është pjesë e këtij dimensionit njohës dhe mënyra sesi ai i percepton ato, stimujt, situatat dhe varet nga proceset njohëse ose pritshmëritë e vetë-efikasitetit të perceptuar. Ata priren të presin për pjesën tjetër, duke i perceptuar si të pavlefshëm dhe i refuzojnë kur e konsiderojnë veten të paaftë dhe me mungesë vlerash personale, por kur e vlerësojnë veten si njerëz shumë të mirë, ata presin të miratohen nga të tjerët (Jurevičienė, Kaffemaniene, Ruškus, 2012).

Janë ato shenja trupore që ndodhin si aktivizim i sistemit nervor, i qarkullimit të gjakut, i frymëmarrjes dhe i tretjes etj (Jurevičienė, Kaffemaniene, Ruškus, 2012). Në përputhje me këtë, Jurevičienė dhe Kaffemaniene (2018) vë në dukje pjesën e hulumtimit mbi aftësitë sociale si variabla fiziologjike që kanë formuar si më poshtë: presionin e gjakut, rrahjet e zemrës, rrjedhjen e gjakut, përgjigjet elektrodermale dhe frymëmarrjen, (përçueshmëria e lëkurës) dhe përgjigjet elektromiografike (tension-relaksim muskolor).

Një model propozon që mungesa e aftësive sociale do të ishte një dështim për të mësuar komponentët joverbalë, verbalë dhe motorikë të sjelljes shoqërore kompetente. Individit i mungon diapazoni i sjelljes dhe/ose përdor përgjigje të papërshtatshme pasi nuk i ka mësuar ose i ka mësuar gabimisht. Nga ana tjetër, modeli i frenimit të përgjigjes parashtron se individi ka aftësitë e nevojshme në repertorin e tij, por se ata janë të

shtrembëruar ose të frenuar nga ankthi i kushtëzuar nga situatat sociale (Campbell & Hansen, 2010). Vlen të theksohet se pozicionet e mëvonshme kanë ngritur modelin e frenimit, në të cilin ai është një frenim për shkak të proceseve të ndryshme njohëse: besimeve irracionale, vetë-verbalizimeve negative, pritjeve, vetë-udhëzimeve joadekuate, vlerësimeve të shtrembëruara kognitive, standardeve perfeksioniste dhe vetë-kërkuese.

## 2.8 Autizmi

Sipas DSM IV (1994), kriteret diagnostike për çrregullimin autik bazohen në identifikimin e shtrembërimeve të zhvillimit: të tilla si vëmendja dhe perceptimi, të cilat përfshihen në zhvillimin e aftësive sociale dhe gjuhës. Gjithashtu, kriteret për çrregullimin autik përdoren në mënyrë operacionale. Diagnoza kërkon praninë e ndryshimeve cilësore në ndërveprimin dhe komunikimin social. Ai përfshin tre kategori të mëdha:

- Marrëdhënie jonormale reciproke shoqërore,
- Ndryshime në komunikim dhe lojë me imagjinatë,
- Kufizimi i gamës së aktiviteteve dhe interesave (stereotipe).

**a.1.** Për diagnozën e autizmit, duhet të plotësohen gjashtë ose më shumë manifestime të një sërë çrregullimesh (1) të marrëdhënies, (2) të komunikimit dhe (3) fleksibilitet. Plotësimi i të paktën dy elementeve të (1), një nga (2) dhe një nga (3).

Çrregullimi cilësor i marrëdhënieve, i shprehur në të paktën dy nga manifestimet e mëposhtme:

- ◆ Dëmtime të konsiderueshme në shumë sjellje të marrëdhënieve joverbale, si shikimi i syve, shprehja e fytyrës, qëndrimet e trupit dhe gjestet për të rregulluar ndërveprimin social.
- ◆ Pamundësia për të zhvilluar marrëdhënie me bashkëmoshatarët e duhur për nivelin e zhvillimit.
- ◆ Mungesa e sjelljeve spontane që synojnë ndarjen e kënaqësive, interesave ose arritjeve me njerëz të tjerë (të sjelljeve të drejtuarit me gisht ose të shfaqjes së objekteve me interes).
- ◆ Mungesa e reciprocitetit social ose emocional.

Çrregullime cilësore të komunikimit, të shprehura në të paktën një nga manifestimet e mëposhtme:

- Vonesa ose mungesa e plotë e zhvillimit të gjuhës gojore (që nuk synohet të kompensohet me mjete alternative të komunikimit, si gjestet ose mimika).
- Tek njerëzit me të folur adekuat, dëmtime të konsiderueshme në aftësinë për të nisur ose mbajtur biseda.
- Përdorimi stereotip ose i përsëritur i gjuhës, ose përdorimi i gjuhës idiosinkratike.
- Mungesa e lojës spontane dhe të larmishme të shtirjes ose lojërave imituese sociale të përshtatshme për nivelin e zhvillimit.



Modele kufizuese, të përsëritura dhe stereotipe të sjelljes, interesit ose aktivitetit, të shprehura në të paktën një nga manifestimet e mëposhtme:

- Shqetësim i tepruar për një fokus interesi të kufizuar dhe stereotip, jonormal në intensitetin ose përmbajtjen e tij.
- Aderim në dukje jo fleksibël ndaj rutinave ose ritualeve specifike dhe jofunksionale.
- Stereotipi motorike të përsëritura (dridhje duarsh, përdredhje gishtash, lëvizje komplekse të të gjithë trupit).
- Preokupim i vazhdueshëm me pjesë të objekteve.

**a.2.** Para moshës tre vjeçare, vonesat ose shqetësimet duhet të ndodhin në një nga tri fushat: (1) Ndërveprimi social, (2) Përdorimi komunikativ i gjuhës ose (3) Loja simbolike.

**a.3.** Çrregullimi nuk shpjegohet më mirë nga sindroma Rett ose çrregullimi shpërbërës i fëmijërisë.

Njerëzit me çrregullim autik, tregon DSM-IV, kanë një gamë të gjerë simptomash në sjelljen e tyre, të cilat përfshijnë hiperaktivitet, vëmendje shumë të shkurtër, impulsivitet, agresivitet, sjellje vetëdëmtuese dhe veçanërisht te fëmijët zemërim. Mund të ketë përgjigje të çuditshme ndaj stimujve ndijor. Për shembull, pragjet e larta të dhimbjes, mbindjeshmëria ndaj tingujve ose prekjes, reagimet e tepërta ndaj dritave dhe aromave, magjepsja me stimuj të caktuar. (DSM-IV, 1994)

## 2.8.1 Përkufizimi

Termi autizëm u përdor për herë të parë nga Eugenio Bleuler në 1906, për të përshkruar ndryshimet e “pacientëve psikiatrikë rreth të menduarit dhe humbjes së kontaktit me realitetin”. Më pas u përdor nga Kanner në 1943 për të grupuar karakteristikat e 11 fëmijëve me sjellje të paaftësisë për të vendosur kontakt të përshtatshëm afektiv, pamundësi për t'u lidhur me njerëzit e tjerë. Në fund të Luftës së Dytë Botërore, Hans Asperger (1944) e përshkroi sindromën për herë të parë nën emrin “psikopati autike në fëmijëri”, një hetim që u mor nga Lorna Wing (1981) dhe u botua në revistën “Psychological Medicine” nën titullin “Sindroma Asperger” (Beqiri, 2019).

Ka shumë përkufizime të autizmit, të cilët thonë se autizmi është një ndryshim në zhvillimin global të fëmijës që ndikon në gjuhën, njohjen dhe ndërveprimin social të tyre. Përkufizimet e tjera janë më përjashtuese dhe stigmatizuese. Nga ana tjetër, Nano (2017) nga një vizion më aktual dhe gjithëpërfshirës, shpjegon se autizmi është një grup kushtesh të shumëllojshme që ndërpresin proceset komunikuese-relacionale dhe çojnë në krijimin e mënyrave të ndryshme për të komunikuar dhe përpunuar informacionin, një “klasë e re e perceptimit shqisor, e cila përfshin disa modifikime në senso-perceptimin dhe që manifestohet gjithashtu në një ndryshim të theksuar në ndërgjegjësimin individual dhe shoqëror” (Nano, 2017).

## 2.8.2 Etiologjia dhe prevalenca

Në autizmin e fëmijërisë, përcaktimi i tij është kushtëzuar, thuajse vetëm, nga ekzistenca e atyre shenjave dhe simptomave karakteristike që ndikojnë thelbësisht në komunikimin, zhvillimin shoqëror dhe proceset njohëse, në mënyrë të veçantë dhe karakteristike, ku nuk ka aq rëndësi vonesa apo deficit, por shtrembërimi apo devijimi i thellë i zhvillimit, duke mbetur i fshehur etiologjia, shkaku themelor dhe mekanizmat patogjenë që sjell kjo sindromë. (Sauer et al, 2021)

### Gjenetika

Autizmi ka një shkak gjenetik, megjithëse këta faktorë nuk janë të mjaftueshëm për të shpjeguar vetë problemin dhe, në të njëjtën kohë, transmetimi trashëgues përfshin një anomali konjitive që mund të shkaktojë autizëm, por nuk mund të kufizohet ekskluzivisht në këtë gjendje. Ky lloj studimi, ndonëse i vështirë për t'u kryer për shkak të prevalencës së ulët të çrregullimit dhe akoma më shumë, tek binjakët, është jashtëzakonisht interesant, pasi binjakët ndajnë të njëjtin mjedis intrauterin, kështu që përputhshmëria mund të pasqyrojë rrënjësisht trashëgiminë gjenetike, përveç dëmtimi gestacional ose infeksioni intrauterin, më pak i përputhshëm në rezultate. Shkaku i autizmit ka shumë të ngjarë të jetë një predispozitë gjenetike që ndikon në zhvillimin e trurit para lindjes. Shenjat dhe simptomat shfaqen gradualisht dhe mund të identifikohen plotësisht vetëm pas vitit të dytë të jetës. Autizmi vjen në shkallë të ndryshme, duke përfshirë një spektër të gjerë dhe mund të ndodhë me inteligjencë të lartë dhe të ulët (Blakemore dhe Frith, 2007).

### Ndryshime kromozomike

Mund të pohojmë se sindroma e brishtë e kromozomit X nuk lidhet veçanërisht me autizmin e fëmijërisë, por me prapambetjen mendore, që shfaqet vetëm tek ata meshkuj autikë me një deficit të rëndë në funksionet njohëse. (Ruiz-Leyva, 2009).

### Sëmundje infektive

Virusi i rubeolës, fruthit dhe lisë së dhenve tek nënat shtatzëna evidenton etiologjikisht lehtësimin e autizmit tek gratë shtatzëna (Leyva, 2009).

### Sëmundje imunologjike

Autizmi i fëmijërisë mund të jetë një çrregullim autoimun (një çrregullim që ndodh kur trupi ngatërron qelizat e veta me substanca të huaja dhe i sulmon ato), pasi ka gjetur antitrupa në gjak në vendet e receptorëve të serotoninës, duke ndryshuar metabolizmin e tyre (Nano, 2017).

### Ndryshime/sëmundje metabolike

Mungesa gjenetike e enzimës adenil suksinat liazë, e cila bën që purinat (komponimet që përmbajnë azot) të grumbullohen në trup dhe të prodhojnë, teorikisht, defektin bazë që shkakton autizmin (Sauer et al, 2021).

## **Disbalanca e neurotransmetuesve**

### **Serotonina**

Për të validuar pyetësorin e stilit të prindërimit fillimisht u krye analiza faktoriale në një kampion prej 50 nëna të fëmijëve me autizëm dhe më pas u realizuan:

#### III- Besueshmëria

a- konsistenca e brendëshme – testi Cronbach alfa

b-testim -ritestim



**Figura 3.2 Skema e procesit të përdorur për validimin e pyetësorëve**

## II-Validimi i Shkallës së Stilit të Prindërimit

**Analiza faktoriale e validitetit të strukturës së Shkallës së Stilit të Prindërimit.** Për të ekzaminuar dimensionet e pyetësorit u krye analiza faktoriale në 50 nëna të fëmijëve autikë.

Tabela 3.2 Metoda e ekstraktimit: Analiza e Komponenteve Kryesore me rrotullimin varimax.

Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy.		.597
Bartlett's Test of Sphericity	Approx. Chi-Square	200.2
	Df	153
	Sig.	.006

Tabela e mësipërme tregon dy testet kryesore që përdoren për të treguar vlefshmërinë e analizës faktoriale të cilët janë : Kaiser-Meyer-Olkin që tregon përshtatshmërinë e kampionit dhe testi i Sfericitetit i Barlet.

Janë ekstraktuar dhe u mbajtën 5 vlera të variancës të cilat përbëjnë 71.6% të variancës totale.




Figura 3.3 Metoda Scree plot.

Grafiku i mësipërm paraqet numrin e faktorëve që kanë rezultuar nga analiza faktoriale.

Numri i faktorëve u përcaktua nga: (a) metoda scree plot (b) vlerat e variancës mbi 1. (c) interpretueshmëria e faktorëve. KMO and Bartlett's Test. KMO >0.5 dhe testi Bartlett <0.001 sugjerojnë përshtatshmërinë e analizës faktoriale për variablat e pyetësorit.

**Tabela 3.3 Analiza faktoriale- Nënshkallët e pyetësorit**

Nënshkallët	Faktoret				
	1	2	3	4	5
<b>AUTORITATIV</b>					
7. Nxiti fëmijën të flasë për problemet e tij	0.481				
1. Përgjegjës ndaj ndjenjave ose nevojave të fëmijës.	0.547				
12. Jep ngushëllim dhe mirëkuptim kur fëmija është i mërzitur.	0.617				
14. Lavdëron kur fëmija ben sjellje te mirë.	0.858				
27. Ka kohë të ngrohta dhe intime së bashku me fëmijën.	0.858				
25. I shpjegon fëmijës arsyet pse duhen respektuar rregullat.	0.521				
31. Shpjegon pasojat e sjelljes së fëmijës.	0.467				
11. Thekson arsyet e rregullave.	0.632				
5. I shpjegon fëmijës se si ndihemi për sjelljen e mirë dhe të keqe të fëmijës.	0.551				
29. Ndhmon fëmijën të kuptojë pasojat e sjelljes së tij	0.489				
21. Rrespekton mendimin e fëmijës.	0.466				
<b>STILI AUTORITAR</b>					
2. Ndërshkon fizikisht për të kontrolluar sjelljen e fëmijës		0.655			
6. Shpërthim inati kur fëmija është i pabindur.		0.417			
32. Godet me shuplakë fëmijën kur fëmija sillet keq.		0.496			
19. E terheq me forcë fëmijën kur është i pabindur.		0.521			
16. Shpërthen në zemërim ndaj fëmijës.		0.462			
13. Bërtet ose bërtet kur fëmija sillet keq.		0.433			
23. Qorton dhe kritikon vazhdimisht fëmijën.		0.471			
30. Qorton dhe kritikon kur sjellja e fëmijës nuk i plotëson pritshmëritë tona.		0.429			
4. Kur fëmija pyet pse (ai) (ajo) duhet të përputhet, thotë:		0.522			
Sepse kështu thashë, ose jam prindi yt dhe dua të bësh diçka.		0.444			
9. Inkurajon fëmijën të shprehet lirshëm (ai/ajo) edhe kur nuk është dakord me prindërit.		0.481			0.421
15. I jep fëmijës dënim kur (ai) (ajo) shkakton zhurmë për diçka.		0.455			0.410
22. Lejon fëmijën të japë të dhëna për rregullat e familjes.		0.511			0.430
8. E ka të vështirë të disiplinojë fëmijën.		0.426			0.411
<b>STILI NEGLIZHENT</b>					
28. Dënon duke e lënë fëmijën diku vetëm me pak ose aspak shpjegime.			0.513		
20. Parashikon dënime për fëmijën dhe nuk i bën ato në fakt.			0.637		
17. Kërcënon fëmijën me ndëshkim më shpesh sesa duke e dhënë atë në të vërtetë.			0.671		
26. Kërcënon fëmijën si ndëshkim .			0.523		
<b>STILI LEJUES</b>					
24. Përkedhel fëmijën.				0.547	
18. Merr parasysh preferencat e fëmijës në bërjen e planeve për familjen.				0.609	
3. Plotëson dëshirat e fëmijës gjithmonë.				0.620	
9. Inkurajon fëmijën të shprehet lirshëm (ai/ajo) edhe kur nuk është dakord me prindërit.				0.513	0.433
15. I jep fëmijës shpërblim që fëmija të sillet mirë.				0.421	0.462
22. Lejon fëmijën të japë të dhëna për rregullat e familjes.				0.446	0.452
8. E ka të vështirë të disiplinojë fëmijën.				0.511	0.412

Tabela e mësipërme paraqet rezultatin e analizës faktoriale. Kanë rezultuar 5 faktorë të cilët i korrespondojnë pesë shkalleve të pyetësorit.

Analiza faktoriale me vlerë të ngarkesës faktoriale  $> 0.40$  për çdo pyetje rezultoi në një strukturë me 36 pyetje dhe me 4 faktorë të interpretueshëm: I. Stili Autoritativ (21.4% e variaciones); II. Stili Autoritar (28.2%); III. Stili Neglizhent (11.7%); IV. Stili Lejues (9.5%).

Katër prej pyetjeve u ngarkuan në dy nënshkallë duke formuar kështu shkallën e Stilit Miks.

- **Qëndrueshmëria e brëndshme.** Konsistenca e brendshme e instrumentit është ekzaminuar me anë të Cronbach alfa. Janë llogaritur koeficientet alfa Cronbach për nënshkallët e paraqitura në versionin shqiptar të Stilit të prindërimit dhe për shkallën totale. Konsistenca e brendshme është adekuate për të katër nënshkallët: Stili Autoritativ ( $\alpha = 0.79$ ), Stili Autoritar ( $\alpha = 0.80$ ), Stili Neglizhent ( $\alpha = 0.75$ ), Stili Lejues ( $\alpha = 0.74$ ).

Tabela 3.4 Rezultatet e qëndrueshmërisë së brëndshme sipas nënshkallëve.

Stili Nënshkallët	Alfa	P
Stili Autoritativ	0.791	<0 .01
Stili Autoritar	0.801	<0 .01
Stili Neglizhent	0.754	<0 .01
Stili Lejues	0.743	<0 .01

Tabela 3.5 Rezultatet e qëndrueshmërisë së brëndshme sipas shkallës totale.

Matjet	Shkalla totale	Alfa
Matja e parë	Stili i Prinderimit	0.787
Matja e dytë.	Stili i Prinderimit	0.741

Vlerat e koeficientit alfa Chronbach janë më të mëdha se 0.70, duke mbështetur qëndrueshmërinë e brendshme të pyetjeve.



- **Besueshmëria / Stabiliteti me kalimin e kohës. Test -retest**

Analiza e përgjigjeve ndërmjet testimit dhe ritestimit është kryer duke përdorur testin statistikor jo-parametrik Spearman për të llogaritur korrelacionet ndërmjet nënshkallëve për matjen e parë dhe të dytë pas një periudhe 2 javore.

Tabela 3.6 Korrelacionet ndërmjet pyetjeve të nënshkallëve analoge (Koefficienti i korrelacionit Spearman)

Nënshkallët	rho	P
Stili Autoritativ	0.791	<0.01
Stili Autoritar	0.804	< 0.01
Stili Neglizhent	0.905	< 0.01
Stili Lejues	0.871	< 0.01

Vlerat e koefficientit alfa Chronbach janë më të mëdha se 0.70.

Korrelacionet e larta ndërmjet rezultateve të nënshkallëve të Shkallës së Stili te Prindërimit në dy pika kohore tregojnë që instrumenti është i qëndrueshëm me kalimin e kohës.

### 3.9.2 INSTRUMENTI I AFTËSIVE SOCIALE

Lista e kontrollit për aftësi sociale të Goldstein është zhvilluar nga Arnold Goldstein në vitin 1980 dhe rekomandohet për të gjitha vendet. Për qëllimet e këtij studimi është përdorur ky instrument, i cili synon të identifikojë nivelet e aftësive sociale tek fëmijët me autizëm. Për këtë qëllim, ai përbëhet nga 50 pyetje të ndara në gjashtë dimensionet, të cilat janë:

- 1. Aftësitë e para sociale:** Ai përfshin të dish se si të dëgjosh, të fillosh dhe të vazhdosh një bisedë, të formulosh pyetje, të jesh i sjellshëm (përfshin të jesh mirënjohës dhe të japësh komplimente kur kërkohet) dhe të dish se si t'u prezantohesh njerëzve të tjerë dhe t'i prezantosh ata.
- 2. Aftësi të avancuara sociale:** Ka të bëjë me pjesëmarrjen, dhënien e udhëzimeve dhe ndjekjen e tyre, njohjen kur kanë bërë gabim dhe bindjen e të tjerëve.
- 3. Aftësitë që lidhen me ndjenjat:** I referohet nivelit të të kuptuarit të ndjenjave të tyre, të të kuptuarit të të tjerëve, të shprehjes së dashurisë dhe vetë-kompensimit.
- 4. Aftësitë alternative ndaj agresionit:** Përdorni vetëkontroll, mbronit të drejtat e dikujt, reagoni ndaj shakave, shmangni problemet me të tjerët dhe mos hyni në grindje.
- 5. Aftësitë e menaxhimit të stresit:** Aftësia për t'iu përgjigjur një dështimi, për t'iu përgjigjur një ankese, për t'u marrë me mesazhe të përziera, për t'iu përgjigjur një akuze, për t'u përgatitur për një bisedë të vështirë dhe për të përballuar presionin e bashkëmoshatarëve.
- 6. Aftësitë e planifikimit:** Aftësia për të marrë vendime, për të vendosur qëllime, për të zgjidhur problemet sipas rëndësisë së tyre dhe për t'u fokusuar në një detyrë.

Secili nga dimensionet ka një pikë dhe shuma e këtyre dimensioneve do të lejojë marrjen e një rezultati total ose global, gjë që e bën më të lehtë diferencimin e niveleve të aftësive sociale të nënshkalle me një rezultat total të lartë ose të ulët. Rezultati maksimal për të marrë në një pyetje është pesë dhe vlera minimale është një.

Gjithashtu, instrumenti ju nënshtrua një procesi vlerësimi për besueshmërinë nëpërmjet koeficientit të korrelacionit Alfa Cronbach, ku gjeti një vlerë prej 0.88 në pikët e përgjithshme dhe gjashtë dimensionet e tij kaluan 85%, duke treguar besueshmëri të lartë. Për të kontrastuar besueshmërinë e instrumentit me të dhënat e këtij studimi, u përdor testi i koeficientit të korrelacionit të Alfës Cronbach, duke marrë një vlerë prej  $\alpha=0.94$ , duke nxjerrë në pah një nivel të lartë dhe domethënës të listës së kontrollit të aftësive sociale sipas Goldstein.

## 4.0 PROCEDURA

Në nivel përshkrues, të dhënat e marra nga administrimi i instrumenteve për stilet e prindërimit dhe lista kontrollit lidhur me aftësitë sociale për kampionin e fëmijëve me autizëm që ndjekin nivelin e mesëm do të paraqiten në tabela të ndryshme dhe figura përshkruese të variablit kryesor, si dhe të testeve statistikore përkatëse të masave të tendencës qendrore.

Përsa i përket analizës konkluzive, gjatë aplikimit të testit të normalitetit Kolmogorov-Smirnov, u konstatua se nuk ka shpërndarje normale të mostrës. Për këtë arsye, statistika me të cilën do të përcaktohet marrëdhënia ndërmjet variablave është përmendur më poshtë.

Testi i koeficientit të korrelacionit të Spearman-it do të përdoret në nivelin konkluzion, i cili do të lejojë kontrastin e hipotezave të propozuara dhe një nivel statistikor të rëndësisë prej 5%.

Statistika e Spearman, sipas Lisama dhe Boccardo (2014) është joparametrike, ajo zbatohet kur shpërndarja e mostrës nuk i përshtatet një shpërndarjeje të njohur; pra nuk shpërndahen sipas lakores normale.

Për të marrë pikët totale për secilin stil prindërimi, në radhë të parë, do të përcaktohet individualisht dhe manualisht se cilin stil prindërimi percepton adoleshenti në shtëpinë e tij. Pasi të njihet stili i prindërimit të secilit prind (nënës), do të shtohen pikët përkatëse për secilin nga dimensionet (angazhimi, autonomia psikologjike dhe kontrolli i sjelljes), në varësi të dimensioneve që merr në konsideratë secili stil.

Rezultatet e marra të secilit grup stilesh, do të ndërlidhen me pikët përkatëse në aftësitë sociale. Numri i kampionit (për korrelacionet që përmbushin objektivat specifike) do të ndryshojë në varësi të numrit të nënave që i korrespondojnë secilit stil prindërimi.

#### **4.1 Metodologjia e analizës statistikore**

Për analizën e të dhënave është përdorur programi statistikor SPSS 25.0.

Variablat e vazhdueshëm janë përmbledhur si mesatare  $\pm$  deviacionin standard (SD).

Normaliteti i shpërndarjes është testuar nëpërmjet testit Kolmogorov-Smirnov.

Për variablat kategorike është llogaritur përqindja e pacientëve në çdo kategori.

Është përdorur testi  $\chi^2$  për krahasimin epërqindjes ndërmjet variablave kategorikë.

Është përdorur testi i studentit  $t$  dhe ANOVA për krahasimin e mesatereve të vazhduar.

Është përdorur analiza e korrelacionit jo-parametrik Spearman për vlerësimin e mardhënies ndërmjet nënshkallëve të pyetësorit të stilit të prindërimit dhe të aftësive sociale.


Vlera e  $p \leq 0.05$  u konsiderua statistikisht e rëndësishme.

Të gjitha testet statistikore janë të dyanshme.

## KAPITULLI 4 REZULTATET

Tabela 4. 1 Karakteristikat socio-demografike nënave të fëmijëve autike

Variablat	N	%	P
<b>Mosha, (MSD)</b>	31.1 (5.38)		
<b>Grupmosha e fëmijëve</b>			
3-6 vjeç	98	58.3	<b>0.03</b>
7-10 vjeç	70	41.7	
<b>Arsimi</b>			
9-vjeçar	13	7.7	<b>&lt;0.01</b>
I mesëm	114	67.9	
I lartë	41	24.4	
<b>Punësimi</b>			
Po	148	88.1	<b>&lt;0.01</b>
Jo	20	11.9	
<b>Vendbanimi</b>			
Urban	113	67.3	<b>&lt;0.01</b>
Rural	55	32.7	
<b>Numri i anëtarëve</b>			
3 anëtarë	50	29.8	<b>&lt;0.01</b>
4 anëtarë	91	54.2	
5 anëtarë	20	11.9	
>5 anëtarë	7	4.2	
<b>Numri i fëmijëve</b>			
1 fëmijë	54	32.1	<b>&lt;0.01</b>
2 fëmijë	88	52.4	
3 fëmijë	18	10.7	
>3 fëmijë	8	4.8	
<b>Niveli ekonomik</b>			
I ulët	42	25.0	<b>&lt;0.01</b>
I mesëm	96	57.1	
I lartë	30	17.9	



**Figura 4. 1 Karakteristikat sociodemorafike të nënave**


Në këtë studim morën pjesë 168 fëmijë autike dhe nënat e tyre. Moshë mesatare e nënave është 31 vjeç që varion nga 18 vjeç – 44 vjeç.

Tek nënat mbizotëron arsimit i mesëm në 67.9% të tyre, 7.7% janë me arsim 9 vjeçar dhe 24.4% me arsim të lartë ( $p < 0.01$ ).

Pjesa më e madhe e nënave (88.1%) janë të punësuar ndërsa 11.9% e tyre nuk janë në punë ( $p < 0.01$ ). Mbizotëron vendbanimi urban (67.3%) kundrejtë rural (32.7%), ( $p < 0.01$ ).

Shumica e familjeve ka nga 4 anëtare (54.2%) ( $p < 0.01$ ) dhe mbizoterojnë familjet me nga 2 fëmijë (52.4%) ( $p < 0.01$ ).

Mbizotëron niveli ekonomik i mesëm (57.1%), ndjekur nga niveli ekonomik i ulët dhe (25%) dhe niveli ekonomik i lartë (17.9%) ( $p < 0.01$ ).



**Figura 4. 2 Shpërndarja e fëmijëve sipas grupmoshës**


58.3% e fëmijëve janë të grupmoshës 3-6 vjeç ndërsa 41.7% janë të grupmoshës 7- 10 vjeç.

## 4.1 Rezultatet e pyetësorëve

Më pas paraqitet raporti i rezultateve, provat e të cilit përshkruhen dhe konkludohen sipas objektivave dhe hipotezave të studimit:

**Tabela 4. 2 Stilet e prindërimit**

	<b>Frekuenca</b>	<b>%</b>
<b>Autoritar</b>	44	26.2
<b>Autoritative</b>	93	55.4
<b>Miks</b>	16	9.5
<b>Lejuese</b>	9	5.4
<b>Neglizhent</b>	6	3.6
<b>Total</b>	168	100.0



**Figura 4. 3 Frekuenca e stileve të prindërimit**


Grafiku i stileve të prindërimit të nënave tregon se shumica e tyre ka nje stil autoritativ (55.4%), ndjekur nga stili autoritar (26.2%), stili miks (9.5%), stili lejues (5.4%) dhe stili neglizhent (3.6%), me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre ( $p < 0.01$ ).



**Tabela 4. 3 Pikëzimi sipas nënshkallëve të stileve të prindërimit**


	<b>M</b>	<b>SD</b>
<b>Autoritar</b>	4.50	1.71
<b>Autoritative</b>	5.25	1.48
<b>Miks</b>	4.25	1.09
<b>Lejuese</b>	4.50	1.32
<b>Neglizhent</b>	4.17	1.07

Në tabelën e mësipërme paraqitet pikëzimi mesatar (M) dhe deviacioni standard (SD).



**Figura 4. 4 Krahasimi i pikëzimit sipas nënshkallëve të stileve të prindërimit**

Nga krahasimi i pikëzimit mesatar u gjet ndryshim sinjifikant ndërmjet stileve të prindërimit (ANOVA  $p=0.04$ ). Pikëzimi më i lartë është për stilin autoritative ( $M=5.25\pm 1.48$ ) dhe më i ulët për stilin neglizhent ( $M=4.17\pm 1.07$ ).




**Figura 4. 5 Krahasimi i pikëzimit të nënshkallëve të stileve të prindërimit sipas vendbanimit**

Nga krahasimi i pikëzimit të stileve të prindërimit sipas vendbanimit u gjet që stili autoritar është më i shprehur në zonën rurale ( $M=4.6\pm 1.5$ ) krahasuar me zonën urbane ( $M=4.2\pm 1.7$ ) ( $p=0.03$ ).

Gjithashtu, stili neglizhent është më i shprehur në zonën rurale ( $M=4.7\pm 1.1$ ) krahasuar me zonën urbane ( $M=4.4\pm 1.3$ ) ( $p=0.04$ ).

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant për stilet e tjera të prindërimit sipas vendbanimit.




**Figura 4. 6** Krahasimi i pikëzimit të nënshkallëve të stileve të prindërimit sipas nivelit arsimor

Nga krahasimi i pikëzimit të nënshkallëve të stileve të prindërimit sipas nivelit arsimor u gjet që nënat me arsim të ulët e kanë më të shprehur stilin autoritar krahasuar me nënat me arsim të mesëm dhe të lartë, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre ( $p=0.02$ ).

Ndërsa stili autoritativ është më i shprehur tek nënat me arsim të lartë, me ndryshim sinjifikant me nënat me arsim të ulët dhe arsim të mesëm ( $p=0.01$ ).

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant në lidhje me nivelin arsimor në stilet e tjera të prindërimit.



**Figura 4. 7 Krahasimi i pikezimit të nënshkallëve sipas nivelit ekonomik**

Në studim u gjet gjithashtu ndikim i nivelelit ekonomik mbi stilët e prindërimit.


Stili autoritar ( $p=0.01$ ) dhe neglizhent ( $p=0.04$ ) janë më të shprehur tek nënat me arsim të ulët ( $p=0.01$ ).

Stili autoritativ është më i shprehur tek nënat me arsim të lartë dhe të mesëm ( $p=0.03$ ). Nuk u gjet ndryshim sinjifikantne lidhje me nivelin ekonomik në stilet e tjera të prindërimit, megjithate stili neglizhet është më i shprehur tek nënat me nivel ekonomik të ulët.

**Tabela 4. 4 Korrelacioni i moshës së nënës me nënshkallët e stilit të prindërimit**

	Autoritar	Autoritativ	Miks	Neglizhent	Lejues
Autoritativ	0.346 0.000				
Miks	0.056 0.504	0.389 0.000			
Neglizhent	-0.109 0.192	-0.140 0.095	-0.639 0.000		
Lejues	-0.314 0.000	0.014 0.865	0.422 0.000	-0.225 0.007	
Mosha, nena	-0.014 0.869	0.024 0.778	0.056 0.501	-0.092 0.274	0.039 0.641

Tabela e mësipërme tregon korrelacionin e Spearman dhe koeficientin e rho dhe vlerën e probabilitetit p.




**Figura 4. 8 Korrelacioni i moshës së nënës me nënshkallët e stilit të prindërimit**

Nuk u gjet korrelacion sinjifikant i moshës së nënës me stilet e prindërimit.

**Tabela 4. 5 Korrelacioni i moshës së fëmijëve me nënshkallët e stilit të prindërimit**

	Autoritar	Autoritativ	Miks	Neglizhent	Lejues
Autoritativ	0.153 0.067				
Miks	0.122 0.144	0.220 0.008			
Neglizhent	-0.091 0.281	-0.116 0.165	-0.665 0.000		
Lejues	-0.152 0.070	-0.089 0.287	0.466 0.000	-0.236 0.004	
Mosha	<b>-0.250</b> <b>0.003</b>	<b>0.382</b> <b>0.000</b>	0.013 0.874	-0.075 0.374	-0.048 0.570

Tabela e mësipërme tregon korrelacionin e Spearman dhe koeficientin e rho dhe vlerën e probabilitetit p.



**Figura 4. 9 Korrelacioni i moshës së fëmijëve me nënshkallët e stilit të prindërimit**

U gjet korrelacion sinjifikant i moshës së fëmijës me stilet e prindërimit. Me rritjen e moshës së fëmijës ulet pikëzimi i stili autoritar të nënës ( $\rho = -0.250$   $p < 0.01$ ) dhe rritet pikëzimi i stilit autoritativ ( $\rho = 0.382$   $p < 0.01$ ), sepse me rritjen e moshës edhe fëmijët kuptojnë më tepër dhe prindërit frenohen më tepër për të qortuar ashpër apo goditur. Nuk u gjet ndryshim sinjifikant në lidhje me korrelacionin e moshës së fëmijëve me stilet e tjera të prindërimit.

❖ Nivelet e aftësive sociale te fëmijët me autizëm

**Tabela 4. 6 Nivelet e aftësive sociale te fëmijët me autizëm për shkallën totale**

	<b>Frekuenca</b>	<b>%</b>
<b>Deficite</b>	130	77.4
<b>Arritje</b>	38	22.6
<b>Total</b>	168	100.0

Në tabelën e mesiperme paraqiten nivelet e aftësive sociale për shkallën totale tek fëmijët me autizëm. Vihet re se shumica e fëmijëve 77.4% shfaq deficite në nivel të arritjeve në aftësitë sociale, ndërsa një grup tjetër më i vogël 22.6% shfaq arritje në përvetësimin e aftësive sociale.

Më poshtë paraqiten nivelet për secilën nënshkallë.

**Tabela 4. 7 Nivelet e aftësive të para bazë**

	<b>Frekuenca</b>	<b>%</b>
<b>Deficite</b>	131	78.0
<b>Arritje</b>	37	22.0
<b>Total</b>	168	100.0

Nivelet e aftësive të para bazë: vihet re se shumica 78% shfaq deficite në përvetësimin e aftësive sociale, ndërsa një grup tjetër më i vogël 22% fitojnë një nivel arritjeje në dimensionin e aftësive bazë sociale.

**Tabela 4. 8. Nivelet e aftësive të avancuara**

	<b>Frekuenca</b>	<b>%</b>
<b>Deficite</b>	149	88.7
<b>Arritje</b>	19	11.3
<b>Total</b>	168	100.0

Niveli i aftësive të avancuara: vihet re se shumica 88.7% shfaq deficite në përvetësimin e aftësive sociale, ndërsa një grup tjetër më i vogël 11.3% fitojnë një nivel të arritjeve në dimensionin e aftësive të avancuara.

**Tabela 4. 9 Nivelet e aftësive që lidhen me ndjenjat**

	<b>Frekuenca</b>	<b>%</b>
<b>Deficite</b>	153	91.1
<b>Arritje</b>	15	8.9
<b>Total</b>	168	100.0

Niveli i aftësive që lidhen me ndjenjat: vihet re se shumica 91.1% shfaq mangësi në përvetësimin e aftësive sociale, ndërsa një grup tjetër më i vogël 8.9% fitojnë një nivel të arritjeve në dimensionin e aftësive lidhur me ndjenjat.

**Tabela 4. 10 Nivelet e aftësive alternative ndaj agresionit**

	<b>Frekuenca</b>	<b>%</b>
<b>Deficite</b>	155	62.3
<b>Arritje</b>	13	7.7
<b>Total</b>	168	100

Nivelet e aftësive alternative ndaj agresionit tek fëmijët me autizëm: vihet re se shumica 92.3% shfaq deficite në përvetësimin e aftësive sociale, ndërsa një grup tjetër më i vogël 7.7% fitojnë një nivel arritjeje në dimensionin e aftësive sociale.

**Tabela 4. 11 Nivelet e aftësive për të përballuar stresin**

	<b>Frekuenca</b>	<b>%</b>
<b>Deficite</b>	154	91.7
<b>Arritje</b>	14	8.3
<b>Total</b>	168	100




Niveli i aftësive për të përballuar stresin: vihet re se shumica 91.7% shfaqin deficite në përvetësimin e aftësive sociale, ndërsa një grup tjetër më i vogël 8.3% fitojnë një nivel arritjeje në dimensionin e aftësive për të përballuar stresin.

**Tabela 4. 12 Nivelet e aftësive të planifikimit**

	<b>Frekuenca</b>	<b>%</b>
<b>Deficite</b>	145	86.3
<b>Arritje</b>	23	13.7
<b>Total</b>	168	100

Niveleve i aftësive të planifikimit tek femijet me autizem: vihet re se shumica 87.3% shfaq deficite në përvetësimin e aftësive, ndërsa një grup tjetër më i vogël 13.7% fitojnë një nivel arritjeje në dimensionin e aftësive për të përballuar stresin.




**Figura 4. 10** Frekuenca e defiçitit dhe arritjes sipas nënshkallëve dhe shkallës totale të aftësive sociale

Arritja më e madhe e fëmijëve është për nënshkallën e aftësive të para bazë (22%) krahasuar me nënshkallët e tjera, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre ( $p < 0.01$ ).

**Tabela 4. 13**Krahasimi i stilit të prindërimit dhe nivelet e aftësive sociale tek fëmijët me autizëm

			Aftësitë sociale		
			Deficite	Arritje	Total
<b>Stilet e prindërimit</b>	<b>Autoritar</b>	<b>f</b>	39	5	44
		<b>%</b>	88.6%	11.4%	100%
	<b>Autoritativ</b>	<b>f</b>	65	28	93
		<b>%</b>	69.9%	30.1%	100%
	<b>Miks</b>	<b>f</b>	13	3	16
		<b>%</b>	81.3%	18.8%	100%
	<b>Neglizhent</b>	<b>f</b>	9	0	9
		<b>%</b>	100%	0%	100%
	<b>Lejues</b>	<b>f</b>	5	1	6
		<b>%</b>	80%	20%	100%
<b>Total</b>		<b>f</b>	130	38	168
		<b>%</b>	77.4%	22.6%	100%



**Figura 4. 11**Krahasimi i stilit të prindërimit dhe nivelet e aftësive sociale tek fëmijët me autizëm

Një përqindje e lartë 100% e vendosur në nivel të deficiteve të aftësive sociale evidentohet në stilin neglizhent, e ndjekur nga 88.6% në stilin autoritar kanë deficite në përvetësimin e aftësive sociale. Në stilin e përzier 81.3% kanë një nivel të deficiteve në aftësitë sociale në stilin autoritativ 69.9% dhe së fundi, stili lejues me 80% kanë deficite në përvetësimin e aftësive sociale. Në përgjithësi, në stilet e prindërimit paraqesin një nivel të deficiteve të aftësive sociale prej 77.4% ndërsa 22.6% kanë përvetësuar aftësitë

sociale. Arritjet më të mëdha janë për stilin autoritative me 30.1%, me ndryshim sinjifikant me stilet e tjera të prindërimit

## 4.2 Rezultatet e testit Kolmogorov-Smirnov

**Tabela 4. 14** Testi i normalitetit Kolmogorov-Smirnov


		HS	EC
N		168	168
Parametrat normal <sup>a,b</sup>	Mesatarja	183.276	61.728
	Deviacioni standard	27.2914	8.2196
Dallimet maksimale ekstreme	Absolut	.057	.004
	Pozitiv	.035	.049
	Negativ	-.057	-.050
Rëndësia statistikore		.057	.050
Sig.asimpt (2-tailed)		.037 <sup>c</sup>	.050 <sup>c</sup>

Në tabelën e mësipërme paraqitet testi i normalitetit Kolmogorov Smirnov. Duke u bazuar në këtë test u gjetën vlera më të vogla se 0.05, gjë që tregon se të dhënat kanë një shpërndarje jo normale ose joparametrike, duke marrë parasysh përdorimin e testit statistikor të Spearman's Rho për të kontrastuar hipotezat e ekspozuara.

**Tabela 4. 15** Pikezimi i nënshkallëve të aftësive sociale për totalin e fëmijëve

Nënshkalla	M	SD
A. e hershme shoqërore	2.81	1.32
Aftësi të avancuara shoqërore	2.75	1.32
Aftësi alternative	2.70	1.33
A. lidhen me ndjenjat	2.78	1.32
Aftësi për planifikim	2.84	1.32
A. për të perballua stresin	2.79	1.33

Në tabelën e mësipërme paraqitet pikëzimi mesatar (M) dhe deviacioni standard (SD).




**Figura 4. 12** Pikëzimi i nënshkallëve të aftësive sociale për totalin e fëmijëve

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant në lidhje me pikëzimin e nënshkallëve të aftësive sociale për totalin e fëmijëve.

**Tabela 4. 16** Pikëzimi i nënshkallëve të aftësive sociale të fëmijëve sipas grupmoshës

Nënshkalla	3-6 vj		7-10 vj		P
	M	SD	M	SD	
A. e hershme shoqërore	2.52	1.24	3.23	1.13	<0.01
A. të avancuara shoqërore	2.50	1.36	3.14	1.15	<0.01
Aftësi alternative	2.60	1.13	2.83	1.29	0.3
A. lidhen me ndjenjat	2.62	1.46	2.99	1.22	0.09
Aftësi për planifikim	2.74	1.28	2.97	1.17	0.3
A. për të perballuar stresin	2.65	1.32	2.98	1.25	0.1


Në tabelen e mësipërme paraqitet pikëzimi mesatar (M) dhe deviacioni standard (SD).



**Figura 4. 13** Pikëzimi i nënshkallëve të aftësive sociale të fëmijëve sipas grupmoshës

Nga krahasimi i pikëzimit nënshkallëve të aftësive sociale të fëmijëve sipas grupmoshës u gjet që fëmijët e grupmoshës 7-10 vjeç i kanë më të shprehura aftësitë e hershme shoqërore ( $M=3.23\pm 1.13$ ) ( $p<0.01$ ) dhe aftësitë e avancuara shoqërore ( $M=3.14\pm 1.15$ ) ( $p<0.01$ ) krahasuar me fëmijët e grupmoshës 3-6 vjeç, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre pa patur parasysh llojin e stilit të prindërimit.


Gjithashtu në studim u vlerësuan aftësitë sociale të fëmijëve sipas grupmoshës dhe sipas secilit stil të prindërimit.



**Figura 4. 14 Niveli i shkallës totale të aftësive sociale sipas stilit autoritar dhe autoritativ dhe grupmoshës**


Në studim u gjet që niveli i shkallës totale të aftësive sociale në stilin autoritar është më i lartë në grupmoshën 3-6 vjeç ( $M=3.3\pm 1.3$ ) krahasuar me grupmoshën 7-10 vjeç ( $M=2.2\pm 0.96$ ), me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre, që tregon që stili autoritar jep rezultate më të mira në grupmoshën 3-6 vjeç.

Niveli i shkallës totale të aftësive sociale në stilin autoritativ është më i lartë në grupmoshën 7-10 vjeç ( $M=3.6\pm 0.96$ ) krahasuar me grupmoshën 3-6 vjeç ( $M=2.7\pm 1.6$ ) me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre, që tregon që stili autoritativ jep rezultate më të mira në grupmoshën 7-10 vjeç.



**Figura 4. 15** Pikëzimi i nënshkallëve të aftësive sociale të fëmijëve sipas grupmoshës dhe sipas stilit autoritar

Siç tregohet edhe në grafikun e mësipërm, fëmijët e grupmoshës 3-6 vjeç paraqesin nivele të aftësive sociale më të larta për të gjitha nënshkallët krahasuar me fëmijët e grupmoshës 7-10 vjeç që nënkupton përshtatshmërinë e këtij stili për grupmoshën 3-6 vjeç.




**Figura 4. 16** Pikëzimi i nënshkallëve të aftësive sociale të fëmijëve sipas grupmoshës sipas stilit autoritar




Në grafikun e mësipërm vërehet që niveli i aftësive sociale për të gjitha nënshkallët në stilin autoritativ është më i lartë tek fëmijet e grupmoshës 7-10 vjeç.

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant i aftësive sociale të fëmijëve sipas grupmoshës përsa i përket stileve të tjera të prindërimit.




**Figura 4. 17 Niveli i stresit tek prindërit**

Nivel i lartë i stresit u gjet në shumicën e nënave (81%) krahasuar me 19% të nënave të cilat kishin nivel të ulët/moderuar të stresit me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre ( $p < 0.01$ ).



**Figura 4. 18 Niveli i stresit sipas ashpërsisë së ASD**

Niveli i ashpërsisë së ASD u gjet i lidhur ndjeshëm me nivelin e stresit të prindit. Nënata fëmijët e të cilëve kishin ASD të rëndë raportuan më shumë stres në krahasim me prindërit fëmijët e të cilëve kishin nivel të ulët/të moderuar të ASD. Nivel i lartë stresi u gjet në 126 (96.2%) nga 130 nënat e fëmijëve me ASD të rëndë dhe në 11 (28.9%) nga 38 nënat e fëmijëve me ASD të lehtë ( $p < 0.01$ ).




**Figura 4. 19 Niveli i stresit sipas stilit të prindërimit**

Stili i prindërimit autoritar u gjet i lidhur ndjeshëm me nivelin e stresit të prindërit, fëmijët e të cilëve kishin ASD më të rëndë (95.5%) me ndryshim sinjifikant me stilet e tjera të prindërimit ( $p = 0.02$ )

Në stilet e tjera të prindërimit niveli i stresit ishte më i ulët si pasojë e nivelit më të lehtë ASD, pa ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre.

### 4.3 Testimi i hipotezave

**H1: Ekziston një marrëdhënie domethënëse midis stileve të prindërimit dhe aftësive sociale të fëmijët me autizëm.**



**Figura 4. 20 Korrelacioni ndërmjet stileve të prindërimit dhe aftësive sociale të fëmijët me autizëm. Shkalla totale.**


Nga krahasimi i shkallëve totale të stilit të prindërimit dhe aftësive sociale të fëmijëve nuk u gjet marrëdhënie sinjifikante.

**Tabela 4. 17 Korrelacioni ndërmjet stileve të prindërimit dhe aftësive sociale të fëmijët me autizëm për shkallën totale**

Rho e Spearman		Aftësitë sociale
Stilet e prindërimit	Koeficienti i korrelacionit	0.119
	Sig. (2-tailed)	0.1
	N	168

Tabela tregon një nivel rëndësie statistikore  $p=0.1$  duke pranuar hipotezën nul dhe duke hedhur poshtë hipotezën alternative të studimit. Pra nuk ka lidhje midis stileve të

prindërimin dhe aftësi sociale tek fëmijët me autizëm përsa i përket shkallës totale. Gjithashtu, u gjet një koeficient korrelacioni Spearman prej  $Rho=0.119$  i cili tregon një korrelacion pozitiv të dobët.



**Figura 4. 21 Korrelacioni i llojeve të stileve të prindërimit dhe nivelit të aftësi sociale të fëmijëve**

Nga korrelacioni i stileve të prindërimit të aplikuar, me shkallën totale të aftësi sociale të fëmijëve u gjet ndryshim sinjifikant për shkallën autoritare dhe autoritative.

Për stilin autoritativ u gjet korrelacion pozitiv ( $\rho=0.214$   $p=0.01$ ) d.m.th. ky stil inkurajon zhvillimin e aftësi sociale të fëmijës, ndërsa për stilin autoritar u gjet korrelacion negativ ( $\rho=-0.138$   $p=0.03$ ) d.m.th ky stil frenon zhvillimin e aftësi sociale tek fëmijët.

**Tabela 4. 18 Korrelacioni i stileve të prindërimit me shkallën e aftësi sociale**

Shkalla: A. sociale	Shkalla: Stili prindërimit	N	rho	95% CI for $\rho$	P-Value
Sociale	Autoritativ	168	0.214	(0.052, 0.365)	<b>0.01</b>
Sociale	Lejues	168	0.103	(-0.061, 0.262)	0.2
Sociale	Miks	168	0.038	(-0.127, 0.200)	0.6
Sociale	Neglizhent	168	-0.115	(-0.273, 0.050)	0.1
Sociale	Autoritar	168	-0.138	(-0.295, 0.026)	<b>0.03</b>

**H2: Stili autoritativ i prindërimit lidhet pozitivisht me aftësitë sociale të fëmijëve me autizëm.**

**Tabela 4. 19 Korrelacioni i stilit autoritativ të prindërimit dhe niveleve aftësive sociale**

Rho e Spearman		Aftësitë sociale
Stilet e prindërimit	Koeficienti i korrelacionit	0.214
	Sig. (2-tailed)	<b>0.01</b>
	N	168

Në tabelën e mësipërme mund të shihet koeficienti i korrelacionit Spearman prej  $Rho=0.214$  cili tregon një korrelacion pozitiv dhe një marrëdhënie të rëndësishme duke pranuar hipotezën e propozuar. Gjithashtu u përftua një nivel i rëndësishëm statistikore  $p=0.01$  e cila tregon se ka një marrëdhënie domethënëse midis variablave të studimit, d.m.th. ky stil inkurajon zhvillimin e aftësive sociale të fëmijës.

**H3: Stili i prindërimit autoritar lidhet negativisht me aftësitë sociale të fëmijëve me autizëm.**

**Tabela 4. 20 Korrelacioni i stilit të prindërimit autoritar dhe niveleve të aftësive sociale**

Rho e Spearman		Aftësitë sociale
Stilet e prindërimit	Koeficienti i korrelacionit	-0.138
	Sig. (2-tailed)	<b>0.03</b>
	N	168

Në tabelën e mësipërme mund të shihet koeficienti i korrelacionit Spearman prej  $Rho = -0.33$ , i cili tregon një korrelacion të dobët negative dhe një marrëdhënie të rëndësishme. Kjo tregon se ndërmjet dy variablave ka marrëdhënie duke mbështetur kështu hipotezën e propozuar. Gjithashtu, u përftua një nivel i sinjifikancës  $p=0.03$ . Domethënë ka një lidhje të rëndësishme midis variablave të studimit. Ky stil frenon zhvillimin e aftësive sociale tek fëmijët.

**H4: Stili lejues i prindërimit lidhet negativisht me aftësitë sociale të fëmijëve me autizëm.**

**Tabela 4. 21**Korrelacioni i stilit lejues të prindërimit dhe niveleve të aftësive sociale

Rho e Spearman		Aftësitë sociale
Stilet e prindërimit	Koeficienti i korrelacionit	0.103
	Sig. (2-tailed)	0.2
	N	168

Tabela e mësipërme tregon një koeficient të korrelacionit Spearman prej  $Rho = 0.103$ . i cili tregon një korrelacion pozitiv të dobët. Gjithashtu, u përftua një nivel rëndësie statistikore  $p = 0.2$ , kështu që pranohet hipoteza nul që do të thotë se nuk ka asnjë marrëdhënie midis variablave të studimit.

**H5: Stili neglizhenti prindërimit lidhet negativisht me aftësitë sociale të fëmijëve me autizëm.**

**Tabela 4. 22**Korrelacioni i stilit të prindërimit neglizhues dhe niveleve të aftësive sociale

Rho e Spearman		Aftësitë sociale
Stilet e prindërimit	Koeficienti i korrelacionit	-0.115
	Sig. (2-tailed)	0.1
	N	168

Tabela e mësipërme tregon koeficientin e korrelacionit Spearman të  $Rho = -0.15$  që tregon një korrelacion me një tendencë negative dhe një fortësi të ulët. Në këtë kuptim, sa më i lartë të jetë stili i prindërimit neglizhent, aq më të ulëta janë aftësitë sociale. Nga ana tjetër, u përftua niveli i rëndësisë statistikore  $p = 0.1$ , pra nuk ka asnjë marrëdhënie domethënëse midis variablave të studimit duke pranuar hipotezën nul.

**H6: Stili i përzier i prindërimit lidhet negativisht me aftësitë sociale të fëmijëve me autizëm.**


**Tabela 4. 23 Korrelacioni i stilit të përzier prindëror dhe niveleve të aftësive sociale**

Rho e Spearman		Aftësitë sociale
Stilet e prindërimit	Koeficienti i korrelacionit	0.038
	Sig. (2-tailed)	0.6
	N	168

Tabela e mësipërme tregon koeficientin e korrelacionit Spearman prej  $Rho = 0.038$ . i cili tregon një korrelacion shumë të dobët. duke hedhur poshtë hipotezën e propozuar. Gjithashtu, u përftua një nivel i rëndësishëm statistikore  $p = 0.6$ . e cila sugjeron se nuk ka asnjë lidhje midis këtyre variablave të studimit.


## HULUMTIMI I POHIMEVE

Për të njohur arësyet e disa prej pohimeve, nënat u pyetën për shkaqet që i shtyjnë drejt pohimit. Kjo u krye për të njohur më mirë kontekstin e prindërimit dhe për të adresuar dhe përmirësuar stilin e prindërimit të tyre.



**Figura 4. 22 A keni rregulla që fëmija juaj duhet të ndjekë gjatë ditës?**


Shumica e nënave (63.6%) kane rregulla që fëmija duhet të ndjekë gjatë ditës.



**Figura 4. 23 Nese Po, ku janë të shfaqura?**




Rregullat janë të shfaqura në nëmyrë të njëjtë (nga 33.3%) tek dhoma e fëmijës, frigoriferi dhe muri i kuzhinës.




**Figura 4. 24 Çfarë rregullash shtëpiake prisni që ai/ajo të ndjekë?**

Mbizotërojnë rregullat e zonës së caktuar (40%) ndjekur nga sjellja brenda shtëpisë (20%).




**Figura 4. 25 Sa mirë funksionon kjo sjellje me fëmijën tuaj?**

80% e nënave referojnë që kjo qasje funksionon shumë mirë




**Figura 4. 26 A ka fëmija juaj punë ose përgjegjësi të rregullta që ai ose ajo pritet të bëjë çdo ditë ose çdo javë?**

81.8% e nënave referojnë që fëmija e tyre ka punë ose përgjegjësi të rregullta që ai ose ajo pritet të bëjë çdo ditë ose çdo javë



**Figura 4. 27 Shpërblimi nëse i bën?**

88.9% e nënave referojnë që fëmija e tyre merr shpërblim material nëse i zbaton rregullat.




**Figura 4. 28 Pasojat nëse nuk i bën?**

Pasojat nëse nuk i bën konsistojnë në kujtesën e tyre (66.7) dhe heqjen e privilegjeve (22.2%) dhe asgjë (11.1%).


A informoni fëmijët në lidhje me sjelljen e duhur, kur bëni një aktivitet? (Psh. park, qëndër tregtare, restorant etj.) PO (100%)

A e paralajmëroni fëmijën tuaj përpara se ai ose ajo të shfaqë sjellje të pahijshme? (p.sh., "Nëse e godet vëllanë përsëri ose shokun, do të rrish brenda") PO (100%)




**Figura 4. 29 Sa mirë funksionon kjo sjellje me fëmijën tuaj?**

45.5% e nënave referojnë që kjo qasje funksionon mirë 18.2% shumë mirë dhe 36.4% pak.




**Figura 4. 30 Cilat sjellje rezultojnë në dhënien e reagimeve korigjuese, qortimit ose bërtitjes ndaj fëmijës tuaj?**

Të gjitha sjelljet e mësipërme rezultojnë nga 10% secila




**Figura 4. 31 Sa shpesh e korigjoni, bërtisni apo qëlloni fëmijën?**

30% e nënave referojnë që i bërtasin fëmijës disa herë në javë dhe 10% njëherë në javë.




**Figura 4. 32 Sa mirë funksionon kjo sjellje me fëmijën tuaj?**

50% e nënave referojnë që kjo qasje funksionon mire 20% shumë mirë dhe 30% pak.




**Figura 4. 33 Cilat sjellje çojnë në heqje të privilegjit nëse fëmija sillet keq?**

Sjella më e keqe e fëmijës është kur godet prindin (27.3%).



**Figura 4. 34 Sa shpesh ja hiqni privilegjet?**


30% e nënave referojnë që i heqin privilegjet fëmijës disa herë në javë



**Figura 4. 35 Sa mirë funksionon kjo sjellje me fëmijën tuaj?**


60% e nënave referojnë që kjo sjellje funksionon mirë 10% shumë mirë dhe 30% pak.

A e shpërbleni fëmijën tuaj për sjelljen e duhur? PO (100%)



**Figura 4. 36 Çfarë merr ai/ajo si shpërblim, dhe/ose privilegj?**


Mbizotëron shpërblimi: përqafime/lavdërime në 54.5% të rasteve



**Figura 4. 37 E fiton shpërblimin shpesh fëmija juaj?**


72.7% e nënave referojnë që shpërblimin fëmija e fiton shpesh.






**Figura 4. 38 A humbet fëmija juaj një shpërblim për sjellje te keqe?**

45.5% e nënave referojnë ndonjëherë, 36.4% referojnë po dhe 18.2% jo..




**Figura 4. 39 Sa mirë funksionon kjo qasje me fëmijën tuaj?**

63.6% e nënave referojnë që kjo qasje funksionon shumë 18.2% jashtë mase shumë mirë dhe 18.2% vetëm pak.




**Figura 4. 40 Brenda një dite, sa kohë ka kaluar fëmija juaj me prindin në shtëpi?**

Shumica e nënave (81.8%) referojnë që brenda një dite kanë kaluar > 4 orë me fëmijën e tyre.



**Figura 4. 41 Sa përqind të kohës e dini se ku ndodhet fëmija juaj kur ai/ajo është larg mbikëqyrjes suaj të drejtpërdrejtë?**

Shumica e nënave (72.7%) referojnë që e dinë se ku ndodhet fëmija juaj kur ai/ajo është larg mbikëqyrjes së tyre të drejtpërdrejtë.



**Figura 4. 42 Sa përqind të miqve të fëmijës suaj i njihni mirë?**

45.5% e nënave referojnë që i njohin pothuajse të gjithë miqtë e fëmijës së tyre, 27.3% rreth 50% të miqve dhe 27.3% rreth 75% të miqve.

## KAPITULLI 5

### DISKUTIM

Një numër i përgjithshëm 168 fëmijë autike dhe nënat e tyre. Nëna të fëmijëve me çrregullim të spektrit autik u zgjodhën qëllimisht për studim. Për marrjen e informacionit janë përdorur dy pyetësorë (Pyetësori i dimensionit të stilit të prindërimit dhe i Aftësisë sociale të fëmijëve).

Nga analiza faktoriale e pyetësorit të stilit të prindërimit kanë rezultuar 5 faktorë të cilët i korrespondojnë pesë shkallëve të pyetësoritë.

Mosha mesatare e nënave është 31 vjeç që varion nga 18 vjeç – 44 vjeç.

Tek nënat mbizotëron arsimit mesëm në 67.9% të tyre, 7.7% janë me arsim 9 vjeçar dhe 24.4% me arsim të lartë.

Shumica e nënave (88.1%) janë të punësuar ndërsa 11.9% e tyre nuk janë në punë. Mbizotëron vendbanimi urban (67.3%) kundrejtë rural (32.7%).

Shumica e familjeve ka nga 4 anëtarë dhe mbizotërojnë familjet më nga 2 fëmijë.

Mbizotëron niveli ekonomik mesëm (57.1%), ndjekur nga niveli ekonomik i ulët dhe (25%) dhe niveli ekonomik i lartë (17.9%).

Grafiku i stileve të prindërimit të nënave tregon se shumica e tyre ka një stil autoritativ (55.4%), ndjekur nga stili autoritar (26.2%), stili miks (9.5%), stili lejues (5.4%) dhe stili neglizhent (3.6%), me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre.

Nga krahasimi i pikëzimit mesatar u gjet ndryshim sinjifikant ndërmjet stileve të prindërimit. Pikëzimi më i lartë është për stilin autoritativ dhe më i ulët për stilin neglizhent.

Nga krahasimi i pikëzimit të stileve të prindërimit sipas vendbanimit u gjet që stili autoritar është më i shprehur në zonën rurale krahasuar me zonën urbane.

Gjithashtu, stili neglizhent është më i shprehur në zonën rurale krahasuar me zonën urbane

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant për stilet e tjera të prindërimit sipas vendbanimit.

Nga krahasimi i pikëzimit të nënshkallëve të stileve të prindërimit të nënave sipas nivelit arsimor u gjet që nënat me arsim të ulët e kanë më të shprehur stilin autoritar krahasuar me nënat me arsim të mesëm dhe të lartë, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre.

Ndërsa stili autoritativ është më i shprehur tek nënat me arsim të lartë, me ndryshim sinjifikant me nënat me arsim të ulët dhe arsim të mesëm.

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant në lidhje me nivelin arsimor në stilet e tjera të prindërimit të nënave.

Në studim u gjet gjithashtu ndikim i nivelit ekonomik mbi stilet e prindërimit të nënave.

Stili autoritar dhe neglizhent janë më të shprehur tek nënat me arsim të ulët.

Stili autoritativ është më i shprehur tek nënat me arsim të lartë dhe të mesëm. Nuk u gjet ndryshim sinjifikant në lidhje me nivelin ekonomik në stilet e tjera të prindërimit të nënave, megjithatë stili neglizhet është më i shprehur tek nënat me nivel ekonomik të ulët.

Nuk u gjet korrelacion sinjifikant i moshës së nënës me stilet e prindërimit.

U gjet korrelacion sinjifikant i moshës së fëmijës me stilet e prindërimit. Me rritjen e moshës së fëmijës ulet pikëzimi i stili autoritar të nënës dhe rritet pikëzimi i stilit autoritativ, sepse me rritjen e moshës fëmija zhvillon aftësi bazike më tepër. Në këtë mënyrë fëmija kupton më tepër dhe prindërit frenohen më shumë për ti qortuar ashpër apo mbajtur me forcë. Nuk u gjet ndryshim sinjifikant në lidhje me korrelacionin e moshës së fëmijëve me stilet e tjera të prindërimit.

U gjet që shumica e fëmijëve 77.4% shfaq deficite në nivel të arritjeve në aftësitë sociale, ndërsa një grup tjetër më i vogël 22.6% shfaq arritje në përvetësimin e aftësive sociale.

Arritja më e madhe e fëmijëve është për nënshkallën e aftësive të para bazë (22%) krahasuar me nënshkallët e tjera, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre.

Nivelet e aftësive të para bazë: vihet re se shumica 78% shfaq deficite në përvetësimin e aftësive sociale, ndërsa një grup tjetër më i vogël 22% fitojnë një nivel arritjeje në dimensionin e aftësive bazë sociale.

Niveli i aftësive të avancuara: vihet re se shumica 88.7% shfaq deficite në përvetësimin e aftësive sociale, ndërsa një grup tjetër më i vogël 11.3% fitojnë një nivel të arritjeve në dimensionin e aftësive të avancuara.

Niveli i aftësive që lidhen me ndjenjat: vihet re se shumica 91.1% shfaq mangësi në përvetësimin e aftësive sociale, ndërsa një grup tjetër më i vogël 8.9% fitojnë një nivel të arritjeve në dimensionin e aftësive lidhur me ndjenjat.

Nivelet e aftësive alternative ndaj agresionit tek fëmijët me autizëm: vihet re se shumica 92.3% shfaq deficite në përvetësimin e aftësive sociale, ndërsa një grup tjetër më i vogël 7.7% fitojnë një nivel arritjeje në dimensionin e aftësive sociale. Niveli i aftësive për të përballuar stresin: vihet re se shumica 91.7% shfaqin deficite në përvetësimin e aftësive sociale. ndërsa një grup tjetër më i vogël 8.3% fitojnë një nivel arritjeje në dimensionin e aftësive për të përballuar stresin.

Niveleve i aftësive të planifikimit tek fëmijet me autizem: vihet re se shumica 87.3% shfaq deficite në përvetësimin e aftësive. ndërsa një grup tjetër më i vogël 13.7% fitojnë një nivel arritjeje në dimensionin e aftësive për të përballuar stresin.

Një përqindje e lartë 100% e vendosur në nivel të deficiteve të aftësive sociale evidentohet në stilin neglizhent. e ndjekur nga 88.6% në stilin autoritar kanë deficite në përvetësimin e aftësive sociale. Në stilin e përzier 81.3% kanë një nivel të deficiteve në aftësitë sociale në stilin autoritativ 69.9% dhe së fundi. stili lejues me 80% kanë deficite në përvetësimin e aftësive sociale. Në përgjithësi. në stilet e prindërimit paraqesin një nivel të deficiteve të aftësive sociale prej 77.4% ndërsa 22.6% kanë përvetësuar aftësitë sociale. Arritjet më të mëdha janë për stilin autoritativ me 30.1%, me ndryshim sinjifikant me stilet e tjera të prindërimit.

Nuk u gjet ndryshim sinjifikant në lidhje me pikëzimin e nënshkallëve të aftësive sociale për totalin e fëmijëve.

Nga krahasimi i pikëzimit nënshkallëve të aftësive sociale të fëmijëve sipas grupmoshës u gjet që fëmijët e grupmoshës 7-10 vjeç i kanë më të shprehura aftësitë e hershme shoqërore ( $M=3.23\pm 1.13$ ) dhe aftësitë e avancuara shoqërore ( $M=3.14\pm 1.15$ ) krahasuar me fëmijët e grupmoshës 3-6 vjeç, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre.

Nga krahasimi i shkallëve totale të stilit të prindërimit dhe aftësive sociale të fëmijëve nuk u gjet marrëdhënie sinjifikante.

Për stilin autoritativ u gjet korrelacion pozitiv d.m.th. ky stil inkurajon zhvillimin e aftësive sociale të fëmijës, ndërsa për stilin autoritar u gjet korrelacion negativ d.m.th ky stil frenon zhvillimin e aftësive sociale tek fëmijët.

Shumica e nënave (63.6%) kanë rregulla që fëmija duhet të ndjekë gjatë ditës.

Rregullat janë të shfaqura në nëmyrë të njëjtë (nga 33.3%) tek dhoma e fëmijës, frigoriferi dhe muri i kuzhinës.

Mbizotërojnë rregullat e zonës së caktuar (40%) ndjekur nga sjellja brenda shtëpisë (20%) dhe 80% e nënave referojnë që kjo qasje funksionon shumë mirë.

81.8% e nënave referojnë që fëmija e tyre ka punë ose përgjegjësi të rregullta që ai ose ajo pritet të bëjë çdo ditë ose çdo javë.

88.9% e nënave referojnë që fëmija e tyre merr shpërblim material nëse i zbaton rregullat. Pasojat nëse nuk i bën konsistojnë në kujtesën e tyre (66.7) dhe heqjen e privilegjeve (22.2%) dhe asgjë (11.1%).

100% e nënave i informojnë fëmijët në lidhje me sjelljen e duhur, kur zhvillohet një aktivitet? (Psh. Shëtitje në park, qendër tregtare, restorant etj.).

100% e nënave i paralajmërojnë fëmijët përpara se ai ose ajo të shfaqe sjellje të pahijshme? (p.sh., "Nëse e godet vëllanë përsëri ose shokun, do të rrih brenda").

45.5% e nënave referojnë që kjo qasje funksionon mirë 18.2% shumë mirë dhe 36.4% pak.

Të gjitha sjelljet që rezultojnë në dhënien e reagimeve korigjuese, qortimit ose bërtitjes fëmijëve rezultojnë nga 10% secila.

30% e nënave referojnë që i bërtasin fëmijës disa here në javë dhe 10% njëherë në javë.

50% e nënave referojnë që kjo qasje funksionon mirë 20% shumë mirë dhe 30% pak.

Sjella më e keqe e fëmijës që çon në heqje të privilegjit është kur godet prindin (27.3%).

30% e nënave referojnë që i heqin privilegjet fëmijës disa herë në javë.

60% e nënave referojnë që kjo qasje funksionon mirë 10% shumë mirë dhe 30% pak.

100% e nënave referojnë që e shpërblejnë fëmijën për sjelljen e duhur?

Çfarë merr ai/ajo si shpërblim, dhe/ose privilegj?

Mbizotëron shpërblimi: përqaftime/lavdërime në 54.5% të rasteve.

72.7% e nënave referojnë që shpërblimin fëmija e fiton shpesh.

45.5% e nënave referojnë që fëmija e humbet dëmshpërblimin ndonjëherë, 36.4% referojnë po dhe 18.2% jo.

63.6% e nënave referojnë që kjo qasje funksionon shumë 18.2% jashtë mase shumë mirë dhe 18.2% vetëm pak.

Shumica e nënave (81.8%) referojnë që brenda një dite kanë kaluar > 4 orë me fëmijën e tyre në shtëpi. Shumica e nënave (72.7%) referojnë që e dinë se ku ndodhet fëmija juaj kur ai/ajo është larg mbikëqyrjes së tyre të drejtpërdrejtë.

45.5% e nënave referojnë që i njohin pothuajse të gjithë miqtë e fëmijës së tyre, 27.3% rreth 50% të miqve dhe 27.3% rreth 75% të miqve.

## KAPITULLI 6

### PËRFUNDIME

Ky studim konsistoi në të kuptuarin e stileve të prindërimit të nënave dhe ndikimin që ato kanë mbi fëmijën, duke formësuar dhe brumosur sjelljen e tij.

